FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 152

Tiranë – E mërkurë, 13 nëntor 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 130/2019, datë 4.11.2019	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 100/2017, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar.....	12467
Vendim i Kuvendit nr. 131/2019, datë 4.11.2019	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr. 99/2017, "Për ngritjen e nënkomisionit 'Për qeverisjen vendore' në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut", të ndryshuar.....	12467
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 30.10.2019	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, për rikonstruksionin dhe rindërtimin e banesave të prekura nga tërmeti i datës 21.9.2019, në qarqet Tiranë dhe Durrës.....	12467
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 6.11.2019	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së grantit për asistencë teknike, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e përgatitjes së një studimi fizibiliteti për projekte të infrastrukturës së transportit në zonat bregdetare jugore të Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 500, datë 29.8.2018, të Këshillit të Ministrave.....	12468
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 6.11.2019	Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2020, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU).....	12469
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 6.11.2019	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të letërmarrëveshjes së grantit nr. TF0A8666, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga dhurues të ndryshëm, nën fondin e besimit shumëdhurues, për mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar 2, për financimin e projektit për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar 2, miratuar me vendimin nr. 81, datë 20.2.2019, të Këshillit të Ministrave.....	12469

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 6.11.2019	Për dhënie kontributi financiar, nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi, për blerjen e teksteve shkollore	12470
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 714, datë 6.11.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", të ndryshuar	12471
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 721, datë 11.11.2019	Për përcaktimin e dokumentacionit, shumës vjetore të transfertës nga buxheti i shtetit dhe procedurave të financimit të fondit të sigurimeve shoqërore për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji	12473
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 11.11.2019	Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre	12474
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 723, datë 11.11.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 492, datë 10.7.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e çmimeve dhe të kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, për vitin shkollor 2019–2020"	12527
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 532, datë 6.11.2019	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti "Hapat e Para", Tiranë	12529
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 262, datë 11.11.2019	Për delegim të përkohshëm kompetencash	12529
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 155, datë 29.10.2019	Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit", miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar	12530
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 156, datë 29.10.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga impianti i përpunimit të mbetjeve urbane, me fuqi të instaluar 2850 kw	12532
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 157, datë 29.10.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Hydro Power Panarit" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali "Vile", me kapacitet të instaluar 1994 kw, për një afat 30-vjeçar	12535
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 158, datë 29.10.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "HEC Arsti" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Arsti"	12537
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 159, datë 29.10.2019	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., me nr. 274, seria T15, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 35, datë 4.3.2015, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike	12539

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 160, datë 29.10.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë HEC-i "Kabash Porocan" sh.p.k., për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të bankës "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a.	12540
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 161, datë 29.10.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë "Përparimi SK" sh.p.k., për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të bankës "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a.	12542
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 162, datë 29.10.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë HEC "Lashkiza" sh.p.k., për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të bankës "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a.	12544
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 1101, datë 1.11.2019	Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, për funksionarin publik z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion kryetar i Bashkisë Vorë, qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"	12545
	Vendim *(i shkurtuar)* për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Edmond Meço.....	12552

VENDIM
Nr. 130/2019

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 100/2017, "PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21/1 e 55, pikat 2 dhe 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 100/2017, "Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

1. Deputetja Artemis Dralo caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.11.2019.

VENDIM
Nr. 131/2019

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 99/2017, "PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT 'PËR QEVERISJEN VENDORE' NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21/1 e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Pavarur,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 99/2017, "Për ngritjen e nënkomisionit 'Për qeverisjen vendore' në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut", të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

1. Në pikën III/1, deputetja Aurora Mara caktohet anëtare zëvendësuese.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 4.11.2019

VENDIM
Nr. 704, datë 30.10.2019

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES, PËR RIKONSTRUKSIONIN DHE RINDËRTIMIN E BANESAVE TË PREKURA NGA TËRMETI I DATËS 21.9.2019, NË QARQET TIRANË DHE DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, në programin buxhetor "Emergjencat Civile" 10910, i shtohet fondi prej

470 000 000 (katërqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2019, për rikonstruksionin dhe rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti në qarqet Tiranë dhe Durrës.

2. Ministria e Mbrojtjes caktohet organi përgjegjës për përdorimin e fondeve për rikonstruksionin dhe rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti, në qarqet Tiranë dhe Durrës, sipas procedurave të prokurimit publik.

3. Të gjitha fondet në programin buxhetor "Emergjencat Civile" 10910, për vitin 2019, do të përdoren për qëllimin e parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 708, datë 6.11.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH TË MARRËVESHJES SË GRANTIT PËR ASISTENCË TEKNIKE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB, PËR FINANCIMIN E PËRGATITJES SË NJË STUDIMI FIZIBILITETI PËR PROJEKTE TË INFRASTRUKTURËS SË TRANSPORTIT NË ZONAT BREGDETARE JUGORE TË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 500, DATË 29.8.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, 12 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së grantit për asistencë teknike, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e përgatitjes së një studimi fizibiliteti për projekte të infrastrukturës së transportit në zonat bregdetare jugore të Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 500, datë 29.8.2018, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FONDI KUVAJTIAN PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

Ref: KF/11 G 6 - 151	Numri total i faqeve: 1	
Data: 30.10.2018	Administrata & Operacionet	CF: AB/45/PY
Faks: (965) 22999190	Telefon: (965) 22999000	Faqja e internetit:
(965) 22999091	Email: operations@kuwait-fund.org	http://www.kuwait-fund.org
Drejtuar: Z. Arben Ahmetaj Ministër i Financave dhe Ekonomisë Ministria e Financave dhe Ekonomisë Tiranë, Republika e Shqipërisë		Faks/email: +355 42 228494

Lënda: Asistenca teknike për financimin e përgatitjes së një studimi fizibiliteti për projekte të infrastrukturës së transportit në zonat bregdetare jugore të Shqipërisë – K.F. Granti nr. 365

Ju njoftojmë, me falënderime, se e kemi marrë letrën tuaj me prot. nr. 18184, të datës 10 tetor 2018, në të cilën kërkuat një shtyrje afati të së drejtës suaj për të kryer tërheqje nga Asistenca Teknike e lartpërmendur, afat i cili përfundon më 31 dhjetor 2018.

Kemi kënaqësinë t'iu njoftojmë, shkëlqesia juaj, se kjo e drejtë do të shtyhet deri më 31 dhjetor 2020.

Duke ju siguruar, shkëlqesia juaj, për bashkëpunimin tonë të vazhdueshëm, ju lutem pranoni urimet tona më të përzemërta.

Marwan Al-Ghanem
Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Operacioneve
13030 2921
Faks: (965) 22999090/22999091
Tel: (965) 22999000
P.O.Box: 2921 Safat, 13030 Kuwait
Email: info@kuwait-fund.org
Faqja e internetit: www.kuwait-fund.org

VENDIM
Nr. 709, datë 6.11.2019

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2020, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2020, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), në shumën 49 287 733 (dyzet e nëntë milionë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë, sipas pasqyrës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)
PASQYRA NR. 1
PLANI I SHPENZIMEVE
PËR VITIN 2020

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2020 (lekë)
1.	Pagat dhe shtesat e tjera	31 638 443
2.	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	5 606 592
3.	Shërbime e furniturë	11 910 698
4.	Investime	132 000
	TOTALI	**49 287 733**

VENDIM
Nr. 710, datë 6.11.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH TË LETËRMARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF0A8666, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA DHURUES TË NDRYSHËM, NËN FONDIN E BESIMIT SHUMËDHURUES, PËR MBËSHTETJEN PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR ZBATIMIN E SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR 2, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR ZBATIMIN E SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR 2, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 81, DATË 20.2.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të letërmarrëveshjes së grantit nr. TF0A8666, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe

Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga dhurues të ndryshëm, nën Fondin e Besimit Shumëdhurues, për mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar 2, për financimin e projektit për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar 2, miratuar me vendimin nr. 81, datë 20.2.2019, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

BANKA BOTËRORE WORLD BANK GROUP OFFICE
BNRZH • IDA | GRUPI I BANKËS BOTËRORE
Vienna, Austria, 1020

LINDA VAN GELDER
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe i Azisë Qendrore

27 qershor 2019

Shkëlqesisë së saj, Anila Denaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë
SHQIPËRI

E nderuar znj. ministre,

Shqipëri: Mbështetje për Ngritjen e Kapaciteteve për Zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI)2
Granti nr. TF013972 dhe Granti nr. TF0A8666
Ndryshimi i Marrëveshjes së Grantit dhe i Letër Marrëveshjes

I referohemi Marrëveshjes së Grantit (TF013972), të datës 7 mars 2013, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Banka Botërore), e ndryshuar; dhe Letërmarrëveshjes (TF0A8666) së datës 30 tetor 2018, ndërmjet Marrësit dhe Bankës Botërore që vepron si administratore e fondeve të grantit të siguruar nga dhurues të ndryshëm (Dhurues) nën fondin e besimit Shumëdhurues për Mbështetje në Ngritjen e Kapaciteteve për Zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar 2 (SPI)2; i referohemi dhe shkresës suaj me nr. prot. 3423/3, të datës 9 prill 2019, ku i kërkoni Bankës Botërore të shtyjë datën e disbursimit të fondeve për grantet e përmendura më sipër, sipas Marrëveshjes së Gantit dhe të Letër Marrëveshjes përkatëse.

Kemi kënaqësinë t'ju informojmë se Banka Botërore pajtohet me kërkesën tuaj dhe, për këtë arsye, ka vendosur 30 qershorin 2020, si datën e fundit për qëllimet e seksionit 3.03 të aneksit të Marrëveshjes së Grantit dhe të Letër Marrëveshjes përkatëse.

Të gjithë termat dhe kushtet e tjera të të dyja Marrëveshjeve, me përjashtim sa është ndryshuar këtu, mbeten në fuqi dhe në efekt të plotë.

Sinqerisht,

(Nënshkrimi)

Linda Van Gelder
Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe i Azisë Qendrore

cc: Z. Patrizio Pagano, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore

Tel.: +43 (1) 2170 782
Faks: +43 (1) 2170 701

VENDIM
Nr. 712, datë 6.11.2019

PËR DHËNIE KONTRIBUTI FINANCIAR, NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR KËSHILLIN KOMBËTAR SHQIPTAR NË SERBI, PËR BLERJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 69/2012,

"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e kontributit financiar, në shumën 20 000 (njëzet mijë) euro, ose ekuivalentin e saj në monedhën kombëtare, për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi, për t'u përdorur për blerjen e teksteve shkollore.

2. Kundërvlera në lekë e shumës së sipërpërmendur të transferohet në formën e transfertës, në llogari të përfituesit dhe të përballohet nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në programet buxhetore "arsimi bazë", "arsimi i mesëm i përgjithshëm", "sporti" dhe "rinia".

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 714, datë 6.11.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 686, DATË 29.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM) DHE PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË VENDIMIT E DEKLARATËS MJEDISORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, fjalët "... me shkrim ..." zëvendësohen me "... nëpërmjet sistemit elektronik ...".

2. Në kreun I bëhen ndryshimet, si më poshtë vijojnë:

a) paragrafi i fundit, i pikës 1.2, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Raporti paraprak i VNM-së të jetë i nënshkruar elektronikisht nga personi fizik/juridik i licencuar.".

b) pika 2 shfuqizohet.

c) paragrafi i parë, i shkronjës "b", të pikës 4, ndryshohet si më poshtë vijon:

"b) dërgon për mendim/konsultim aplikimin, nëpërmjet sistemit elektronik, institucioneve të mëposhtme, të cilat shprehen brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike:".

ç) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e marrjes së aplikimit nga AKM-ja, e dërgon për mendim nëpërmjet sistemit elektronik te njësia/të e vetëqeverisjes vendore, ku propozohet projekti, të cilat shprehen brenda 6 (gjashtë) ditëve kalendarike nga marrja e aplikimit.".

3. Në kreun II bëhen ndryshimet, si më poshtë vijojnë:

a) pika 2 shfuqizohet.

b) paragrafi i parë, i shkronjës "b", të pikës 4, ndryshohet si më poshtë vijon:

"b) u dërgon për mendim/konsultim aplikimin, nëpërmjet sistemit elektronik, institucioneve të mëposhtme, të cilat shprehen brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike:".

c) pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. ARM-ja, brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e marrjes së aplikimit nga AKM-ja, e dërgon për mendim nëpërmjet sistemit elektronik te njësia/të e vetëqeverisjes vendore ku propozohet projekti, të cilat shprehen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga marrja e aplikimit.".

ç) paragrafi i parë, i pikës 10, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Për t'u pajisur me deklaratën mjedisore zhvilluesi aplikon pranë ministrisë nëpërmjet sistemit elektronik dhe plotëson dokumentacionin e mëposhtëm:".

4. Kreu III ndryshohet si më poshtë vijon:

"KREU III
TRANSFERIMI I VENDIMIT APO I DEKLARATËS MJEDISORE

1. Kur zhvilluesi ndryshon, pasi ka përfunduar procedura paraprake e VNM-së, zhvilluesi i ri paraqet pranë AKM-së, në sistemin elektronik për vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëpërmjet portalit *e-Albania*, kërkesën për transferimin e vendimit për VNM-në paraprake, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin ekzistues;

b) aktin/kontratën për transferimin e veprimtarisë, nga zhvilluesi ekzistues te zhvilluesi i ri;

c) raportin mbi zbatimin e kushteve të vendimit për VNM-në paraprake, nga koha e pajisjes me vendim deri në momentin kur kryhet kërkesa për transferimin e tij.

2. Transferimi i vendimit për procedurë paraprake të VNM-së bëhet me urdhër të titullarit të AKM-së. Urdhri i transferimit i përcillet zhvilluesit të ri, nëpërmjet sistemit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Kur zhvilluesi ndryshon, pasi ka përfunduar procedura e thelluar e VNM-së, zhvilluesi i ri paraqet pranë ministrisë, në sistemin elektronik për vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëpërmjet portalit *e-Albania*, kërkesën për transferimin e deklaratës mjedisore, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) deklaratën mjedisore ekzistuese;

b) aktin/kontratën për transferimin e veprimtarisë, nga zhvilluesi ekzistues te zhvilluesi i ri;

c) raportin mbi zbatimin e kushteve të deklaratës mjedisore, nga koha e pajisjes me deklaratën mjedisore, deri në momentin kur kryhet kërkesa për transferimin e saj.

4. Transferimi i deklaratës mjedisore bëhet me urdhër të ministrit. Urdhri i transferimit i përcillet zhvilluesit të ri, nëpërmjet sistemit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës.".

II. Dispozita tranzitore

1. Nga data 1 dhjetor 2019 fillon aplikimi *online* në portalin *e-Albania* për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

2. Kërkesat për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis, gjatë periudhës 1 dhjetor 2019–28 shkurt 2020, dorëzohen edhe në formë shkresore pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin, deri në funksionimin e plotë të sistemit elektronik të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

3. Pranimi, shqyrtimi i kërkesave për procesin e VNM-së, lëshimi i të gjitha dokumenteve, si dhe ndërveprimi institucional nga data 1 mars 2020, kryhen vetëm nëpërmjet sistemit elektronik të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

4. Kërkesat e dorëzuara në formë shkresore, deri në datën 28 shkurt 2020, shqyrtohen nga ministria përgjegjëse për mjedisin në formën e paraqitur. Nga data 1 mars 2020, ministria përgjegjëse për mjedisin nuk pranon dhe shqyrton më kërkesa në formë shkresore.

5. Ministria përgjegjëse për mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si dhe të gjitha institucionet përgjegjëse për vlerësimin e ndikimit në mjedis, marrin të gjitha masat, që, brenda datës 1 dhjetor 2019, të dorëzojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të gjitha të dhënat dhe bazën materiale të nevojshme për pajisjen e nëpunësve të përfshirë në procesin e shqyrtimit të kërkesave për VNM-në me kredencialet për aksesimin e sistemit, si dhe me nënshkrim elektronik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, marrin të gjitha masat që, brenda datës 1 dhjetor 2019 të trajnojnë nëpunësit, të caktuar si përdorues të sistemit elektronik të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

III. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 721, datë 11.11.2019

PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT, SHUMËS VJETORE TË TRANSFERTËS NGA BUXHETI I SHTETIT DHE PROCEDURAVE TË FINANCIMIT TË FONDIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE PËR TRAJTIMIN FINANCIAR SUPLEMENTAR TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË, TË PUNONJËSVE TË INDUSTRISË SË NAFTËS E TË GAZIT DHE TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË METALURGJI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 13, të ligjit nr. 29/2019, "Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për të përfituar pension për shkak të profesionit, personat që plotësojnë kushtet sipas ligjit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të sigurimeve shoqërore, plotësojnë dhe dorëzojnë në strukturat vendore të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara ose në agjencitë lokale të sigurimeve shoqërore kërkesën për caktim pensioni sipas formatit të miratuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të shoqëruar me:

a) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit, i cili duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë, i nënshkruar nga vetë personi;

b) Vërtetimin e zyrës së Gjendjes Civile në rast të ndryshimit të gjenealiteteve;

c) Librezën e punës të plotësuar në të gjitha rubrikat sipas llojit të punës;

ç) Vërtetimin për bazën e vlerësuar për periudhat e punësimit nga data 1.1.1994 deri në datën e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare nga puna ose vetëpunësimi;

d) Vërtetimin e posaçëm të konfirmimit të llojit të punës në profesionet e vështira, sipas përcaktimeve në këtë ligj dhe në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni", i lëshuar nga ndërmarrja ku personi ka qenë i punësuar, kur subjekti është aktiv ose nga dokumentacioni arkivor i sigurimeve shoqërore;

dh) Vërtetimin për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për burrat);

e) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton llojin dhe periudhën e punës për efekt pensioni, i njohur për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Për të përfituar shtesë mbi pensionin sipas nenit 4, të ligjit të nr. 29/2019, "Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji", personat që plotësojnë kushtet e neneve 3 e 6, të këtij ligji, dhe janë përfitues të pensionit sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, "Mbi sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të pensionit të parakohshëm sipas nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, si dhe sipas ligjit nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë", kur data e lindjes të së drejtës për pension është deri më 31.12.2014, plotësojnë dhe dorëzojnë në strukturat vendore të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara ose në agjencitë lokale të sigurimeve shoqërore dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën për përfitimin e shtesës mbi pension, sipas formatit tip të miratuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

b) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit, të nënshkruar personalisht, i cili duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë;

c) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton llojin dhe periudhën e punës për efekt pensioni, i njohur për zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore vendos në dispozicion të kërkuesve, brenda 10 (dhjetë) ditësh

nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, formatin e kërkesës për përfitimin e pensionit për shkak të profesionit dhe për përfitimin e shtesës mbi pensionin, si dhe formatin e vërtetimit të posaçëm të konfirmimit të llojit të punës në profesionet e vështira.

4. Në rastet kur subjektet punëdhënëse nuk janë aktive ose janë të mbyllura, dokumentacioni vërtetues i llojit të punës dhe kohëzgjatjes së saj, si dhe baza e vlerësuar për efekt të kalkulimit të pensionit plotësohen nga strukturat përgjegjëse të sigurimeve shoqërore dhe bashkohen në dokumentacionin e dosjes së përfitimit, duke ia bërë të njohur edhe personit kërkues.

5. Në zbatim të nenit 8, të ligjit të nr. 29/2019, "Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji", shuma e transfertës nga buxheti i shtetit dhe procedurat e financimit të fondit të sigurimeve shoqërore realizohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të shtetit.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, bazuar në numrin e kontribuesve të këtyre industrive dhe normës kontributive të caktuar me ligj, parashikon të ardhurat nga kontributet. Bazuar në numrin e përfituesve, masën mesatare të përfitimit, shtesën e numrit të përfituesve të rinj dhe pakësimit të përfituesve nga daljet në pension pleqërie llogariten shpenzimet e nevojshme.

Diferenca mes shpenzimeve dhe të ardhurave parashikohet për t'u përballuar nga buxheti i shtetit në vitin përkatës. Kjo miratohet nga Këshilli i Ministrave si pjesë e buxhetit të sigurimeve shoqërore në buxhetin e shtetit.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 29, datë 23.5.2019, "Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji", dhe i këtij vendimi, për vitin 2019, llogariten në shumën 725 000 000 (shtatëqind e njëzet e pesë milionë) lekë dhe përballohen nga fondet e programuara në buxhetin e sigurimeve shoqërore të vitit 2019.

7. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 5 korrik 2019.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 722, datë 11.11.2019

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL DHE TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE E TË DETYRAVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "c", të nenit 30, të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. OBJEKTI DHE SUBJEKTET PËRFITUESE

1. Modeli biopsikosocial i vlerësimit të aftësisë së kufizuar do të zbatohet në qarqet Tiranë, Durrës dhe Elbasan, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, afateve të përcaktuara në vendimin nr. 380, datë 5.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumentit politik 'Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019–2024 për zbatimin e tij'", dhe nëpërmjet përdorimit të Regjistrit Elektronik Kombëtar.

2. Në vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar do të përfshihen individët, që:

a) kërkojnë të vlerësohen për herë të parë;

b) kërkojnë të rivlerësohen, të cilët kanë përfituar pagesë të aftësisë së kufizuar sipas legjislacionit në fuqi.

II. KRITERET E PËRFITIMIT DHE DOKUMENTACIONI I PRANIMIT

1. Për marrjen e përfitimeve të aftësisë së kufizuar duhet të plotësohen kriteret, si më poshtë vijojnë:

a) personi duhet të ketë një gjendje mjekësore të vërtetuar të një dëmtimi fizik, mendor, intelektual apo ndijor të lehtë, mesatar, të rëndë ose të thellë;

b) duhet të vërtetohen kufizime të lehta, mesatare, të rënda ose të thella, të shkaktuara nga dëmtimi;

c) duhet të vërtetohen kufizime mesatare, të rënda, të thella për të kryer veprimtari domethënëse të jetesës së përditshme, të përshtatshme për moshën e personit dhe për të marrë pjesë në jetën shoqërore, ekonomike e politike;

ç) personi duhet të përjetojë kufizime të konsiderueshme mjedisore dhe të qëndrimit, të cilat ndikojnë në aftësinë për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe pjesëmarrje të barabartë në shoqëri;

d) personi duhet të jetë i paaftë për punë dhe të mos plotësojë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës, sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

dh) personit duhet të mos i ketë lindur e drejta për përfitim të pensionit të pleqërisë/social sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

2. Dokumentacioni për përfitimin e aftësisë së kufizuar përfshin:

a) formularin e aplikimit, sipas formatit 1 bashkëlidhur këtij vendimi;

b) formularin e plotësuar nga mjeku i familjes, sipas formatit 2, për të rritur, ose sipas formatit 3, për fëmijë, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) formularin e plotësuar nga mjeku specialist i qendrave shëndetësore të specialiteteve apo të spitaleve, kur nuk mbulohet nga qendrat shëndetësore, sipas formatit 4, për të rritur, ose sipas formatit 5, për fëmijë, bashkëlidhur këtij vendimi. Për sëmundjet e shëndetit mendor ky formular plotësohet nga Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor (QKSHM). Për fëmijët, formulari mund të plotësohet edhe nga Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve (QKMZHRF);

ç) kopjen e letërnjoftimit/certifikatës personale me fotografi.

3. Dokumentet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, dorëzohen/postohen pranë zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

III. VLERËSIMI BIOPSIKOSOCIAL

1. Procesi i mbështetur në modelin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar përfshin vlerësimin mjekësor të aplikuesit nga mjeku i familjes dhe nga mjeku specialist/QKSHM-ja, një intervistë me aplikuesin në zyrën e vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë të kufizuar me mjekë dhe punonjës socialë, verifikimin e informacionit të marrë dhe kontrollin vjetor mjekësor.

2. Vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizuar dhe i nivelit të kufizimeve funksionale bëhet në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar mbi Funksionimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ky vlerësim përfshin faktorët që dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët, në përputhje me udhëzuesit për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar për të rriturit dhe fëmijët, të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe për shëndetësinë.

3. Administrimi i procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar realizohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.

4. Pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror krijohen komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, të cilat funksionojnë në nivel rajonal, që përbëhen nga punonjës me kohë të plotë dhe kanë në përbërje, së paku, një mjek dhe një punonjës social për çdo komision, të trajnuar për modelin biopsikosocial të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara. Çdo komision asistohet nga një punonjës, i cili administron dhe regjistron të dhënat e aplikuesit. Komisionet kryesohen nga përgjegjësi i zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Stafi i zyrës së vlerësimit kryen këto detyra:

a) hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat e aplikuesit;

b) vlerëson dhe shqyrton dosjet e paraqitura për vlerësim/rivlerësim;

c) verifikon dhe shkëmben informacionin elektronik me rrjetin e institucioneve të tjera të kujdesit shëndetësor, të arsimit, punësimit e formimit profesional, të sigurimeve shoqërore, tatimeve, strukturave përgjegjëse pranë pushtetit vendor, si dhe institucioneve të tjera, nëpërmjet

Regjistrit Elektronik Kombëtar dhe, kur nuk është e mundur, manualisht/zyrtarisht;

ç) cakton datën e intervistës dhe njofton zyrtarisht kërkuesit, nëpërmjet administratorit shoqëror ose kthen zyrtarisht dosjen për plotësim, kur ka mungesë dokumentacioni, në njësinë administrative;

d) organizon kryerjen e intervistës, sipas formatit 6, bashkëlidhur këtij vendimi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumenteve të aplikimit;

dh) bën vlerësimin për përcaktimin e nevojës për ndihmës personal;

e) përcakton nivelin e përgjithshëm të aftësisë së kufizuar;

ë) bën përgatitjen e rekomandimeve për shërbime të tjera dhe marrjen e vendimit për përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar;

f) lëshon dokumentin që vërteton aftësinë e kufizuar, sipas formatit 7, bashkëlidhur këtij vendimi;

g) shqyrton të dhënat e kontrolleve periodike të nevojshme, të kryera sipas formatit 8, bashkëlidhur këtij vendimi;

gj) mban, ruan dhe përditëson të dhënat e dokumentacionit të kërkuesve e të përfituesve të aftësisë së kufizuar, elektronikisht dhe fizikisht;

h) adreson fëmijët e moshës shkollore pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për vlerësimin e nevojave të tyre arsimore.

5. Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror nxjerr vendimin përfundimtar për të gjithë përfituesit e aftësisë së kufizuar, njofton zyrtarisht aplikuesin për vendimmarrjen dhe e pajis me dokumentin përkatës, që përcakton aftësinë e kufizuar. Vendimi për përfitimet e aftësisë së kufizuar dhe të ndihmësit personal i përcillet bashkisë, për:

a) zbatimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit;

b) kryerjen e veprimeve financiare për dhënien e pagesës për përfituesit e aftësisë së kufizuar.

6. Administratori shoqëror pranë organeve të pushtetit vendor, lidhur me menaxhimin e rasteve të personave me aftësi të kufizuara, ka përgjegjësi për:

a) hartimin e një plani individual të përvitshëm të shërbimeve, mbështetur në rekomandimet e komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit;

b) kryerjen e vizitave në mjedisin ku jeton individi, jo më pak se një herë në tre muaj;

c) informimin e zyrës së vlerësimit për ndryshimin e gjendjes së personit me aftësi të kufizuara;

ç) informimin e individëve për shërbimet shoqërore ekzistuese nën juridiksionin e bashkisë/njësisë administrative, në territorin e së cilës është banor individi;

d) informimin e individëve për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë për vlerësim/rivlerësim të aftësisë së kufizuar;

dh) informimin e familjarëve për të drejtat e personit me aftësi të kufizuara për t'u përfshirë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore;

e) informimin e familjarëve për të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar;

ë) monitorimin dhe mbështetjen e shërbimit të asistencës personale;

f) evidentimin, raportimin dhe referimin e rasteve të abuzimit e të neglizhencës;

g) evidentimin dhe verifikimin e rasteve të personave që përfitojnë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, informimin e strukturave përgjegjëse të shërbimit social shtetëror për të kryer verifikimet me institucione të tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre, kur ka dijeni;

gj) ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë jashtë vendit për më shumë se 3 muaj, me përjashtim të personave e të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtarë;

h) ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë jashtë vendit për më shumë se 3 muaj, si dhe të rasteve të përfituesve, të cilët ndodhen jashtë shtetit shqiptar për qëllime kurimi apo rehabilitimi;

i) informimin dhe udhëzimin në komunitetet lidhur me skemën e aftësisë së kufizuar, me anë të fushatave të ndryshme informuese;

j) bashkëpunimin me punonjësit socialë, që janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve në nenin 36, të ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";

k) adresimin e rasteve të personave me aftësi të kufizuara drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore, të arsimit e formimit profesional dhe të punësimit, me qëllim rehabilitimin dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore, në përputhje edhe me rekomandimet e komisionit.

7. Monitorimi i punës së zyrave të vlerësimit të aftësisë së kufizuar realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, në bazë të metodologjisë së kontrollit të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe shëndetësinë.

IV. PËRFITIMET NË PAGESA DHE SHËRBIME

1. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar është një pagesë mujore, që jepet në muajin pasardhës, nga data e vendimit për përfitime, me qëllim përmbushjen e nevojave elementare të lidhura me aftësinë e kufizuar, e cila përfitohet nga personat që janë deklaruar si të tillë me vendim të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

2. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar për të rritur dhe fëmijë është 150% e shumës së pensionit social, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

3. Pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar për të rritur dhe fëmijë janë sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot", të ndryshuar.

4. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar indeksohet nga Shërbimi Social Shtetëror sa herë indeksohet pensioni social dhe në bazë të këtij indeksi.

5. Përfituesit e aftësisë së kufizuar, të cilët vlerësohen se kanë nevojë për paketë higjieno-sanitare, përfitojnë një pagesë shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës higjieno-sanitare, në masën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

6. Niveli i aftësisë së kufizuar dhe përfitimet përcaktohen bazuar në vlerësimin biopsikosocial, të kryer nga komisioni shumëdisiplinor.

7. Pagesat për personat me aftësi të kufizuara kryhen nëpërmjet shërbimeve bankare ose Postës Shqiptare, sipas alternativës së përzgjedhur nga vetë individi.

8. Personat me aftësi të kufizuara, që ndjekin një kurs kualifikimi të licencuar ose të akredituar dhe nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë, përfitojnë pagesë në masën 200% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin kursin/shkollën vetëm për një dhe gjatë një kursi kualifikimi/programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e kursit të kualifikimit/programit të studimit.

9. Studentët, të cilët ndjekin arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përfitojnë pagesë në masën 300% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e programit të studimit. E njëjta masë pagese zbatohet për personat që ndjekin programin e studimit të ciklit të tretë. Për personat që ndjekin studimet e doktoratës dhe për personat që ndjekin procedurat për fitimin e një titulli akademik, kjo pagesë përfitohet në mënyrë të përhershme, mbi bazën e dëshmisë së lëshuar nga organet kompetente për fitimin e gradës shkencore/titullit akademik.

10. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët ndjekin njëkohësisht arsimin e mesëm të lartë apo arsimin e lartë dhe një kurs kualifikimi, përfitojnë vetëm njërën nga pagesat.

11. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë apo të lartë, paraqesin për çdo fillim të vitit shkollor/akademik dokumentet e mëposhtme:

a) vërtetimin e nënshkruar nga titullari dhe sekretari i institucionit arsimor të mesëm të lartë dhe të lartë, ku shënohet emri dhe mbiemri i personit, niveli i arsimit që ndjek, viti shkollor/akademik dhe kohëzgjatja. Për të vërtetuar frekuentimin e procesit mësimor vërtetimi lëshohet çdo tre muaj. Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të çdo sezoni lëshohet vetëm për personat që ndjekin arsimin e lartë;

b) kopjen e noterizuar të dëftesës së çdo viti, kopjen e noterizuar të diplomës në mbarim të shkollës së mesme të lartë apo të lartë dhe/ose kopje të dëshmisë së kursit të kualifikimit.

12. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët kanë fituar gradë shkencore/titull akademik, paraqesin

kopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton fitimin e gradës shkencore/titullit akademik.

13. Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror ose rajonal, ka të drejtë të verifikojë me strukturat përgjegjëse për çështjet e arsimit, vlefshmërinë e dokumentit të lëshuar nga ana e institucioneve arsimore.

14. Personat me aftësi të kufizuara me kufizime të rënda apo të thella gëzojnë të drejtën e përfitimit të ndihmësit personal, kur kjo përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

15. Shkalla e nevojës për shërbimet e ndihmësit personal përcaktohet në bazë të vlerësimit biopsikosocial të kryer nga komisioni shumëdisiplinor.

16. Pagesat për shërbime të ndihmësit personal lidhen me pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar dhe indeksohen nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksimit të pensionit social.

17. Pagesat për shërbime të ndihmësit personal u referohen pagesave të përcaktuara në pikat 16 dhe 17, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

18. Ndihmësit personalë, që ofrojnë këtë shërbim për më shumë se një përfitues, marrin një shtesë prej 50% të shumave përkatëse për çdo përfitues të shtuar.

19. Pagesat për shërbime të ndihmësit personal jepen në muajin pasardhës, pas vendimit të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit. Pagesa kryhet nëpërmjet shërbimeve bankare ose Postës Shqiptare, sipas alternativës së përzgjedhur nga vetë individi.

V. PROCEDURA E ANKIMIMIT

1. Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit për procedurën e vlerësimit në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar. Ankimimi bëhet me shkrim, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit të vendimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, e cila shqyrton dokumentacionin e ankimuesit, kryen intervistën sipas formularit 6, bashkëlidhur këtij vendimi dhe merr vendimin përfundimtar. Në rastet kur kërkesa pranohet, personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji pasardhës, nga data e marrjes së vendimit për refuzim nga komisioni.

2. Personi me aftësi të kufizuar, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, pasi ka ezauruar shkallët e ankimimit administrativ. Personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve, sipas afateve të përcaktuara në vendimin e gjykatës.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Nuk u nënshtrohen procedurës së vlerësimit, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi:

a) të verbrit përfitues ose aplikues, që kërkojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e të verbrit;

b) paraplegjikët dhe tetraplegjikët përfitues ose aplikues, që kërkojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik.

2. Shërbimi Social Shtetëror miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e komisioneve shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në nivel qendror e rajonal dhe protokollin e punës së tyre.

3. Shkronjat "d", "dh", "e" dhe "ë", të kreut IV, dhe çdo përcaktim i vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot", të ndryshuar, të cilat bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

4. Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore shëndetësore e sociale dhe organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në të cilat zbatohet kjo skemë vlerësimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

FORMULAR APLIKIMI

VLERËSIMI I PËRCAKTIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT, KOPSHTI "HAPAT E PARA", TIRANË

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3 dhe 7, të nenit 42 dhe pikës 3, të nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti "Hapat e Para", Tiranë, licencuar me licencë të QKL-së nr: LN-7482-02-2014.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti "Hapat e Para", Tiranë, ka këto detyrime:

a) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbushur që mund të ketë ndaj nxënësit;

b) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të mbulohen nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti "Hapat e Para", Tiranë;

c) të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të administrojë dokumentacionin e depozituar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti "Hapat e Para", Tiranë.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë dhe institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti "Hapat e Para", Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

URDHËR
Nr. 262, datë 11.11.2019

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neneve 12, pika 1 dhe 13, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe nenit 7, pika 3, të rregullores "Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e pjesshëm të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Luan Daci, si vijon:

a) përgatit, thërret e drejton mbledhjen e anëtarëve;

b) përfaqëson Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në marrëdhënie me të tretët;

c) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Kolegjit;

d) nënshkruan aktet e tjera të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me përjashtim të vendimeve;

e) drejton shortin në rastet e përcaktuara në nenet 14, 15, 18, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

2. Delegimi i kompetencave të mësipërme është për periudhën 13 nëntor 2019, deri në 15 nëntor 2019.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Luan Daci.

4. Z. Luan Daci nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Natasha Mulaj

VENDIM
Nr. 155, datë 29.10.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E "METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 201, DATË 4.12.2017, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19/b, nenit 20/a dhe nenit 87, të ligjit 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 14, të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 144, datë 25 6.2018; nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s" miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 95 prot, datë 18.10.2019 dhe propozimin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, për fillimin e procedurës për rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit" miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017 miratoi "Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit".

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 ka miratuar rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit" miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, duke vendosur për ndryshimin e formulës përllogaritëse të përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit:

- Në zbatim të metodologjisë me ndryshimet e mësipërme, ERE-ja ka përcaktuar çmimet mujore të shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nëpërmjet aplikimeve të përmuajshme të OSHEE sh.a.

- Me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 10, datë 21.1.2019 dhe atë nr. 27, datë 18.4.2019, u organizuan seanca dëgjimore midis OSHEE sh.a. dhe Drejtorive Teknike të ERE-s.

- Çështjet e diskutuara në këto seanca renditen në vijim:

- Nevoja për paraqitjen e një bilanci energjetik nga ana e OSHEE sh.a. i cili mund të argumentojë burimin e mbulimit të kërkesës mujore për klientët e FMF (nga RES apo nga tregu i lirë) në zbatim të pikave 4 dhe 9, të nenit 6, të metodologjisë.

- Ndjeshmëria e klientëve FMF në lidhje me çmimet e miratuara për shkak të çmimeve të larta që rezultonin nga çmimi i lartë i blerjes së energjisë nga tregu i parregulluar.

- Llogaritja dhe faturimi i kostove të disbalancave për konsumatorët që furnizohen nga FMF.

- Përcaktimi i çmimit maksimal të blerjes dhe i datës së kursit të këmbimit për llogaritjen e çmimit të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Mënyra e faturimit, afatet e aplikimit dhe miratimit të çmimit të FMF.

- Përcaktimi i kostove direkte në lidhje me aktivitetin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, si dhe mundësinë e axhustimit expost të tyre sikurse parashikohet ne pikën 2, të nenit 6, të metodologjisë.

- Sugjerime nga ana e OSHEE sh.a. në lidhje me amendimin e metodologjisë së FMF.

- OSHEE sh.a. informoi se aktualisht nuk përcakton profil ngarkese bazuar në secilin grup klientësh (industri, tregti, shërbime dhe të tjera). Profilet e ngarkesës do të mund të propozohen pasi të jetë i mundur sigurimi i të dhënave për secilin grup klientësh në periudhën në vazhdim meqenëse këta klientë janë në sistem *online* dhe mund të merren profile orare.

- Në lidhje me afatin e miratimit të çmimit të FMF, për ndryshime referuar nenin 7, pikat 2, 3

dhe 4, të metodologjisë u kërkua që shoqëria të propozojë ndryshime në lidhje me periudhën e aplikimit dhe afatet e miratimit nga ana e ERE-s, në mënyrë që OSHEE sh.a. të mund dërgojë vetëm një faturë te klientët FMF, ku të reflektohet konsumi dhe çmimi i miratuar.

- Në periudhën nëntor 2018–mars 2019 disa klientë të cilët ndodhen në kushtet e furnizimit nga FMF kanë shprehur në ERE shqetësimin e tyre, në lidhje me çmimin e lartë të furnizimit nga FMF.

- Këto ankesa janë trajtuar nga ERE-ja, duke u bërë të ditur shoqërive rrethanat në të cilat ERE merr vendim mbi çmimet mujore të shitjes së energjisë elektrike nga FMF, në kushtet e legjislacionit në fuqi.

- Me ligjin nr. 7/2018, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 43/2015, 'Për sektorin e energjisë elektrike"', u miratuan ndër të tjera ndryshime në nenin 86, pika 6, të cilat e zgjatën kohën e marrjes së shërbimit të furnizimit me energji elektrike të klientëve të furnizuar në kushtet e FMF, nga 2 muaj në 2 vjet.

- Ndodhur në rrethanat e ndryshimeve që prodhoi dispozita sa më sipër cituar, Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e furnizimit si furnizues i mundësisë së fundit, aktualisht është në kushtet e furnizimit për një periudhë relativisht të gjatë (2 vjet), që i mundëson të parashikojë nevojën për energji për furnizimin e këtyre klientëve duke mos qenë më në kushtet për të kryer blerje emergjente, pra me çmime më të larta.

- Me qëllim që çmimi i përcaktuar nëpërmjet kësaj metodologjie të reflektojë kostot reale të furnizimit nga klientët dhe të shmanget ndërsubvencionimi në rastet kur një furnizues i kryen të dyja funksionet: FSHU/Furnizues i rregullt dhe FMF, duhen të bëhen ndërhyrje në metodologji, në tre drejtime kryesore, të cilat paraqiten në vijim:

- Evidentimi i blerjes së dedikuar të energjisë për klientët FMF. Shoqëria e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të Furnizimit të Mundësisë së Fundit, të ketë detyrimin të dokumentojë sasinë dhe çmimin e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës për klientët në kushtet e FMF nëpërmjet një bilanci energjetik i cili të mund të argumentojë burimin e mbulimit të kërkesës mujore për klientët e FMF.

- Të mundësohet reflektimi i kostove reale të blerjes së energjisë elektrike në çmimin e shitjes së energjisë elektrike të këta klientë. Për këtë propozohet të aplikohet mesatarja e ponderuar për përcaktimin e elementit CBEt në formulën përllogaritëse të nenit 8, të metodologjisë. Në dallim nga çmimi maksimal i blerjes së energjisë, sikurse aplikuar në zbatim të metodologjisë aktuale, koncepti i çmimit mesatar të ponderuar për energjinë e blerë enkas për furnizimin e klientëve FMF, do të përcaktojë koston reale të blerjes së energjisë për ta.

- Faturimi në pik. Gjithashtu, për arsye se CBEt propozohet të reflektojë kostot aktuale nëpërmjet aplikimit të mesatares së ponderuar, për përcaktimin e çmimit të FMF, lind nevoja e aplikimit të çmimit në pik për konsumin e energjisë në masë më të lartë se energjia në bazë, sikurse përcaktuar në pikën e dytë, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 162, datë 30.12.2011, për fashën orare të përcaktuar në vendimin e bordit të ERE-s nr.148, datë 26.12.2014.

- Në mungesë të një propozimi nga pala e interesit, i ngarkuari me detyrimin e furnizimit si FMF, shoqëria OSHEE sh.a, si dhe në ushtrimin e autoritetit në drejtim të miratimit të akteve nënligjore ERE-ja me iniciativë të saj, në mbështetje të nenit 26, pika 1, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s" legjitimohet në cilësinë e propozuesit për ndryshime në këtë akt.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi të ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për disa shtesa dhe ndryshime në "Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit" miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, si më poshtë:

a) Neni 6, pika 3, ndryshon: tarifa që FMF do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit i cili vendoset nga rregullatori.

b) Neni 6, pika 9, ndryshon: kostot, të cilat varen nga vëllimi i energjisë elektrike të furnizuar për këtë kategori klientësh, do të pasqyrohen në mënyrë transparente, jo-diskriminuese dhe do të reflektojnë koston reale të furnizimit, e cila do të

monitorohet nga rregullatori në mënyrë periodike. Furnizuesi i Mundësisë së fundit të japë çdo muaj evidencë të qartë në formën e një bilanci energjetik, i cili të mund të argumentojë burimin e mbulimit të kërkesës mujore për klientët e FMF.

c) Neni 7, pika 2, ndryshon: deri në përcaktimin e çmimit nga ERE-ja, Furnizuesi do të faturojë klientin e furnizuar në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit, me çmimin mesatar të ponderuar të energjisë elektrike të blerë për periudhën në të cilën furnizohet, të publikuar nga FMF, duke pasqyruar kostot administrative, e transmetimit/shpërndarjes, sipas nivelit të tensionit ku është i lidhur konsumatori, si dhe kostot e përcaktuar në pikën 6, të nenit 6.

d) Neni 8, pika 1, ndryshon: CBEt është çmimi mesatar i ponderuar për sasinë e energjisë së blerë për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar dhe nga prodhuesit me përparësi (BRE).

e) Shtohet pika 3, në nenin 8: FMF do të faturojë energjinë në pik, për konsumin në bazë të konsumit për orët e pikut, sipas fashës orare të përcaktuar në vendimin e bordit të ERE-s nr.148, datë 26.12.2014.

f) Kudo në metodologji, fjala konsumator zëvendësohet me fjalën klient i energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja dijeni, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE BORDI
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 156, datë 29.10.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ALBTEK ENERGY" SHPK PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA IMPIANTI I PËRPUNIMIT TË MBETJEVE URBANE, ME FUQI TË INSTALUAR 2850 KW

Në mbështetje të neneve 16, 19 dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar; VKM-së nr. 27, datë 17.1.2018, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale", si dhe nenit 5, pika 20, nenit 19, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 95/6 prot, datë 18.10.2019, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Albtek Energy' sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k. ka paraqitur pranë ERE-s, kërkesën për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, me anë të shkresës së datës 27.8.2019;

- Shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k. ka pasur korrespondencë të vijueshme me ERE-n në lidhje me këtë kërkesë, e cila është adresuar nga ERE-ja edhe më herët në zbatim të legjislacionit në fuqi.

- Në vijim të trajtimit nga ERE-ja të kërkesave të shoqërisë, më herët OSHEE sh.a. me shkresën nr. 4924/2 prot, datë 12.3.2019, protokolluar në ERE me nr. 170/2 prot, datë 15.3.2019, ka bërë

me dije se, ndodhur në kushtet kur nga ERE-ja nuk është përcaktuar çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme, konkretisht energjia e prodhuar nga Impiantet e Trajtimit të Mbetjeve, shoqëria OSHEE sh.a. nuk mund të nënshkruajë kontratë shit-blerje me shoqërinë "Albtek Energy" sh.p.k. dhe shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k. nuk mund të faturojë energjinë e prodhuar.

- Enti Rregullator i Energjisë me shkresat në vijim, me nr. 469/1 prot, datë 17.8.2018; nr. 469/2 prot, datë 17.8.2018; nr. 170/1 prot, datë 28.2.2019; nr. 170/3 prot, datë 27.3.2019, në korrespondencë të vazhdueshme me shoqërinë "Albtek Energy" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë OSHEE sh.a. dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ka informuar palët e interesuara se bordi i ERE-s me vendimin nr. 75, datë 26.3.2018, ka vendosur që shoqëria OSHEE sh.a. të nënshkruajë brenda afateve të vendosura në kontratë/autorizim, me mbajtësin e miratimit përfundimtar nga ministria përgjegjëse për ndërtimin e impianteve nga burimet e rinovueshme, Kontratën Tip të shitblerjes së energjisë elektrike të miratuar nga ERE-ja me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016, i ndryshuar me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016 të bordit të ERE-s.

- Në lidhje me kërkesën e paraqitur me anë të shkresës së datës 27.8.2019, konstatohet se:

- Ligji nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" në pikat 1 dhe 3, të nenit 10, përcakton se çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi për teknologjinë e erës me fuqi deri në 3MW dhe çdo teknologjie tjetër të rinovueshme me fuqi deri në 2MW caktohet nga ERE, në përputhje me metodologjitë e miratuara nga Këshilli i Ministrave. Është e qartë që kufiri i përcaktuar për fuqinë e instaluar në ligjin nr. 7/2017 për teknologjinë MNU, me qëllim të caktimit të çmimit të energjisë elektrike nga ana e ERE-s është 2MW.

- VKM nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" në nenin 11/2 përcakton: Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset OSSH, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE.

- Referuar fuqisë së instaluar të këtij impianti prej 2850 kW, tarifa e shitjes së energjisë elektrike nga ky impiant nuk është objekt i përcaktimit sipas VKM nr. 27, datë 17.1.2018, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale".

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, u shpreh me shkresën nr. 4445/1 prot, datë 4.7.2017 se: për sa i përket citimit te paragrafit 3, të nenit 10, të ligjit 7/2017, është e qartë se burimet e vogla janë impiante të rinovueshme deri në 2 MW. Për rrjedhojë, është e kuptueshme që kjo përcakton detyrimin e ERE-s për të vendosur çmimin e shitjes së energjisë nga këto prodhues të vegjël deri në 2 MW për të gjitha llojet e teknologjive, ndërsa përjashtim bën vetëm prodhimi i energjisë nga era ku kufiri i kapacitetit përcaktohet të jetë 3 MW.

- Shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k. pretendon se konform parashikimeve të nenit 21 dhe 22, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", kërkesa për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë së prodhuar nga ky impiant duhet të shqyrtohet nga ERE.

- Në lidhje me sa më sipër Rregullorja për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, parashikon se:

- Neni 5, pika 19, e "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", parashikon se: "Kërkesë" do të thotë një kërkesë me shkrim e paraqitur në ERE, nga një person për një çështje, që është objekt i rregullimit nga ERE;

- Neni 5, pika 20, e "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", parashikon se: "Aplikues" do të thotë çdo person, i ndryshëm nga ankuesi, i cili paraqet një kërkesë që është nën autoritetin e ERE;

- Neni 19, pika 1, e "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", parashikon se bordi merr vendim për fillimin ose jo të procedurave të shqyrtimit për çdo aplikim që ka të bëjë me ushtrimin nga ERE të autoritetit për: c. përcaktim të tarifave dhe çmimeve të shitjes

së energjisë elektrike dhe të gazit natyror për aktivitetet e rregulluara;

- Neni 19, pika 3, e "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", parashikon se bordi merr vendim për fillimin e procedurave të shqyrtimit nëse konstaton se aplikimi plotëson kryesisht kërkesat sipas rregulloreve përkatëse.

- Për sa më sipër, aplikimi i shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k. nuk është në kushtet e një kërkesë që është objekt rregullimi nga ERE, dhe asnjë kërkesë që është në autoritetin e ERE.

- Shoqëria pretendon se: konform nenit 5, pika 1, të ligjit nr. 138/2013 "Për burimet e energjisë së rinovueshme", nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", si dhe pikës 2, të VKM-s nr. 27, datë 17.1.2018, është mjaft e qartë se të gjitha ligjet e lartpërmendura ia kanë ngarkuar këtë detyrë ERE-s dhe nuk ka asnjë organ tjetër i cili të mund të përcaktojë këtë çmim veç kësaj të fundit.

- Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se:

- Neni 5, pika 1, e ligjit nr. 138/2013 "Për burimet e energjisë së rinovueshme". Ky ligj është shfuqizuar në datën 3.7.2017, nëpërmjet nenit 23, të ligjit 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

- Neni 10, pika 3, e ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", parashikon se: Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga çdo prodhues tjetër me përparësi, i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, caktohet nga ERE, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

- Pika 1, e nenit sipër cituar, shprehet në lidhje me këtë kategori prodhuesish me përparësi:

a) me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 MW;

b) me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 MW për energjinë e erës.

Sa më sipër, në rastin e shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k, fuqia e instaluar e të cilit, referuar licencës së dhënë nga ERE, është 2.85 MW, përjashton çdo pretendim për t'u trajtuar brenda kufijve të parashikuar në këtë dispozitë.

- ERE, bazuar në neni 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" është organi kompetent për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

- ERE përcakton çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për prodhuesit e vegjël deri në 2 MW për të gjitha llojet e teknologjive, ku përjashtim bën prodhimi i energjisë nga era ku kufiri i kapacitetit është 3 MW.

- Në interpretim të nenit 10, të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", është e kuptueshme që objekti i zbatimit të metodologjisë së miratuar me VKM-në nr. 27, datë 17.1.2018 janë impiantet që prodhojnë energji nga MNU me fuqi të instaluar deri në 2 MW. Kjo bëhet e qartë në paragrafin e parë të kësaj metodologjie ku citohet:

- "Teknologjitë e prodhimit të energjisë së rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme të mbetjeve të ngurta mund të llogaritet në nivelin nga 1 deri në 2 MW impiante lokale të instaluara pranë depozitave të MNU, të cilat janë fleksibël për zinxhirin e asgjësimit të këtyre mbetjeve të biodegradueshme në përqendrimet pranë qendrave relativisht të mëdha në vendin tonë".

- Metodologjia e lartpërmendur përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve.

- Në themel të metodologjisë se miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 17.1.2018, është llogaritja e kostos së mesatarizuar të energjisë elektrike për periudhën e vetëshlyerjes (LCOE) e cila përfaqëson koston totale përgjatë ciklit të jetës për prodhimin e 1MWh energji elektrike, duke përdorur një teknologji të caktuar për të shfrytëzuar pjesën e biodegradueshme si burim i rinovueshëm për mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

- Formula llogaritëse e LCOE-se dhe parametrat e nevojshëm për llogaritje paraqiten në vijim:

$$LCOE = \frac{\sum_{t=0}^{n} \frac{C_{I,t}+C_{I.djeg,t}+C_{O\&M,t}}{(1+r)^t}}{\sum_{t=0}^{n} \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

- Bazuar në tipin e kontratës koncensionare të shoqërisë "Kontratë koncesioni e formës BOT 'Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan', e lidhur në dhjetor të vitit 2014, për një afat prej 7 vitesh", komponenti më i rëndësishëm i formulës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, e cila është vlera e investimit për njësi kapaciteti (EUR/MW) nuk është kosto për investitorin dhe për rrjedhojë aplikimi i formulës përllogaritëse të LCOE sipas metodologjisë së lartpërmendur, miratuar me VKM-në nr. 27 datë 17.1.2018, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë së prodhuar për këto lloj kontratash do të ishte i pajustifikuar.

- Bazuar në sa më sipër shpjeguar, siç është theksuar edhe në korrespondencat e mëparshme, konstatohet qartë se impianti për trajtimin e mbetjeve urbane dhe prodhimit të energjisë i shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k, nuk është objekt i rregullimit të çmimit të prodhimit të energjisë elektrike nga ERE sipas përcaktimeve të nenit 10, të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" dhe VKM-së nr. 27, datë 17.1.2018, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale".

- Edhe nëse aplikuesi, shoqëria "Albtek Energy" sh.p.k. do të kishte një fuqi të instaluar brenda kufirit të përcaktuar nga VKM-ja, ERE sërish nuk do të miratonte një çmim për çdo të licencuar, por çmim për energji të prodhuar nga impiantet prodhuese që i korrespondojnë teknologjisë së prodhimit të identifikuar në VKM-në përkatëse.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë "Albtek Energy" sh.p.k, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga impianti i përpunimit të mbetjeve urbane me fuqi të instaluar 2850 KW.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja dijeni, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE BORDI
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 157, datë 29.10.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HYDRO POWER PANARIT" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALI "VILE", ME KAPACITET TË INSTALUAR 1994 kW, PËR NJË AFAT 30-VJEÇAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a" dhe nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a", nenit 10, pika 1 dhe 3, 4 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hydro Power Panarit" sh.p.k., si dhe relacionin nr. 95/4 prot, datë 18.10.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe

Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Hydro Power Panarit" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, nga HEC "Vile" me kapacitet prodhues 1994 kW, në ujërat e rrjedhjes së mesme dhe të poshtme të luginës së përroit të Panaritit, degë e lumit Osum, të qarkut Korçë,

konstatoi se:

- Shoqëria "Hydro Power Panarit" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 587 prot, datë 25.9.2019, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec "Vile" me kapacitet të instaluar 1994 kW.

- Aplikimi i shoqërisë "Hydro Power Panarit" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c"). Rezulton se shoqëria i ka plotësuar të dhënat në lidhje me formatin e aplikimit.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d").

Rezulton se shoqëria i ka plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pika 4.1.1 dhe neni 9, pika 4.1.2).

Rezulton se shoqëria i ka plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.1.4, germat: "a", "b", "d").

Rezulton se shoqëria i ka plotësuar në mënyrë korrekte.

- Leje nga institucione të tjera (neni 9, pika 4.1.5, germat: "a", "b" "c") .

Rezulton se shoqëria i ka plotësuar në mënyrë korrekte.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me miratimin përfundimtar nr. 2441/7 prot, datë 6.7.2017, ka miratuar ndërtimin e HEC Vile me kapacitet prodhues 1994 kW, në ujërat e rrjedhjes së mesme dhe të poshtme të luginës së përroit të Panaritit, degë e lumit Osum të qarkut Korçë.

- MIE pas miratimit përfundimtar sa sipër cituar, ka lidhur me shoqërinë "Hydro Power Panarit" sh.p.k., kontratën me nr. 1951 rep, nr. 882/2 kol, datë 4.9.2017, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit Vile me kapacitet prodhues 1994 kW, në ujërat e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të luginës së përroit të Panarit, degë e lumit Osum, qarku Korçë", me një kohëzgjatje 49 vjet nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritje.

- Paraqitja e përshkrimit të HEC-it, është përcaktuar në projektin e zbatimit përfundimtar të miratuar nga MIE, për të cilin është kryer edhe Oponenca nga AKBN (Raporti i Oponencës Teknike, nr. 835 prot, datë 20.1.2017, dërguar në MIE nga kjo e fundit me shkresën nr. 7286/15 prot, datë 30.1.2017, mbi projektin e zbatimit të HEC Vile).

- Subjekti ka paraqitur në ERE edhe Kontratën e Qirasë, datë 20.4.2017, të lidhur midis Bashkisë Korçë, me cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë Hydro Power Panarit sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, për afatin 2-vjeçar, për një sipërfaqe prej 2.114 ha ose 4.92 km, të ndarë në 3.17 km cungishtë dhe 1.75 km Kullotë, e përfshirë në ekonominë pyjore Vithkuq-Lubonjë në pronësi të Bashkisë Korçë, "Për ushtrimin e veprimtarisë për shtrirje tubacioni dhe linje tensioni të elektrik të HEC Vile dhe një sipërfaqe prej 1.393 ha ose 2.785 km cungishte me qëllim ndërtimin përdorim rruge". Duke ju referuar afatit të lidhjes së kontratës datë 20.4.2017, rezulton se periudha 2-vjeçare (dyvjeçare) e vlefshmërisë së kontratës ka përfunduar në datën 20.4.2019.

- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 3917/3 prot, datë 23.5.2016, drejtuar shoqërisë "Hydro Power Panarit" sh.p.k, i konfirmon "Miratimin e pikës së lidhjes të HEC Vile".

- Shoqëria ka përcjellë në ERE më shkresën nr. 2315 prot, datë 3.8.2018, vendimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me nr. 35 vendimi dhe nr. 584 identifikimi "Për VNM Paraprak", i cili përshkruan se mbas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, vendosi që ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar, për zhvilluesin, personin juridik "Hydro Power Panarit" sh.p.k, për zhvillimin e projektit, për ndërtimin e hidrocentralit "Vile". Kjo leje është dhënë për një kapacitet të instaluar 1994 kW.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: "c", "d" dhe "g". Plotësuar pjesërisht. Mungon: Vërtetimi për

regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra kombëtare e Biznesit, QKB; vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të shoqërisë dhe drejtuesit kryesor të saj dhe dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti).

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik.

Neni 9, pika 4.1.4, germa "e", miratimi i projektit të zbatimit nga MEI.

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

- "Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" në nenin 10, pika 4, parashikon se: ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4, të nenit 8, të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

- Në zbatim të nenit 38, pika 1, germa "a", të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", ERE mund të lëshojë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat deri në 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Hydro Power Panarit" sh.p.k,, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Vile me fuqi 1994 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE BORDI
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 158, datë 29.10.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC ARSTI" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "ARSTI"

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a", nenit 10, pika 1 dhe 3, 4 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "HEC Arsti" sh.p.k., si dhe relacionin nr. 8/4 prot, datë 23.10.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "HEC Arsti" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "HEC Arsti" sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 600 prot, datë 26.9.2019, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Arsti".

- Aplikimi i shoqërisë "HEC Arsti" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:

- Shoqëria "HEC Arsti" sh.p.k, është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i nenit 26, pika 6, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", me kërkesë të autoritetit kontraktues nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, me të cilin lidhet kontrata e koncesionit.

- Kontrata e Koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol, datë 25.5.2016, "Për ndërtimin e HEC Arsti", është lidhur midis Subjektit për Qëllime të Veçanta (SPV) "HEC Arsti" sh.p.k. në cilësinë e Koncesionarit dhe MIE në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

- Kjo kontratë ka një afat 35-vjeçar që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj.

- Me Kontratën shtesë të Koncesionit nr. 2785 rep. dhe nr. 1308/3 kol., datë 14.12.2017, "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol, datë 25.5.2016, të formës BOT "Për ndërtimin e "HEC Arsti", të lidhur midis SPV "HEC Arsti" sh.p.k dhe MIE, është ndryshuar afati për pajisjen me lejet e nevojshme, i cili nga 12 muaj, është bërë, jo më shumë se 24 muaj nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës së Koncesionit".

- Në analizë të sa më sipër rezulton se:

- Sipas Kontratës së Koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol, datë 25.5.2016, "Për ndërtimin e HEC Arsti", janë parashikuar vetëm dy vepra marrje me kapacitet të instaluar 3130 MW.

- Sipas Projektit të zbatimit për të cilin është kryer dhe Oponenca Teknike e AKBN nr. 1943/4 prot, datë 27.4.2017, janë parashikuar tre vepra marrje me kapacitet të instaluar 3410 MW.

- Rezulton se shoqëria nuk ka depozituar në ERE kontratë shtesë koncesioni që të pasqyrojë ndryshimin e parametrave.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa "d" (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria). Mungon vërtetimi i Gjykatës për administratorin e saj, për të deleguarin përgjegjës dhe për vetë shoqërinë, si dhe vërtetimin e prokurorisë për vetë shoqërinë dhe për të deleguarin përgjegjës.

- Neni 9, pika 2, germa "f" (Marrëveshje Koncesioni ose autorizimi nga KM në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës). Nuk rezulton të jetë depozituar në ERE kontratë shtesë Koncesioni për parametrat e ndryshuar të pasqyruar më sipër sipas projektit të zbatimit dhe rekomandimit të Oponencës Teknike, për pasqyrimin e tyre në një kontratë shtesë koncesioni.

- Neni 9, pika 3, germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Shoqëria ka depozituar në ERE bilancet të shoqërive ortake pa dhënë shpjegime lidhur me këtë pikë.

- Neni 9, pika 2, germa "g" (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti).

- Shoqëria "HEC Arsti" sh.p.k. ka depozituar Certifikatat për Vërtetim Pronësie të lëshuar nga ZVRPP Pukë, në datën 30.5.2019, për numrat e pasurive 233/1, 234/1, 235/1, 236/1, 237/1, 238/1, në zonën kadastrale 1054, në pronësi të Bashkisë Fushë-Arrëz, nga përmbajtja e së cilës rezulton se në datën 7.9.2019 është bërë regjistrimi i Kontratës se Koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol, datë 25.5.2016, "Për ndërtimin e HEC Arsti", të lidhur midis SPV "HEC Arsti" sh.p.k. dhe MIE.

- Vendimin nr. 57, datë 25.4.2018, të Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz, "Për dhënien e pëlqimit për dhënien në përdorim të sipërfaqes fond pyjor kullosor në administrim të bashkisë Fushë-Arrëz në zonën kadastrale nr. 1619, me sipërfaqe 3.7728 ha, njësia Administrative Fierzë, në funksion të ndërtimit të "HEC Arsti" nga shoqëria HEC ARSTI sh.p.k.".

- Është depozituar aneksi nr. 1, në të cilin pasqyrohet lista e ngastrave që jepen në përdorim/qira për shoqërinë "HEC Arsti" sh.p.k., për ndërtimin e HEC-it Arsti. Ky aneks, është e paqartë se më cilën kontratë qiraje lidhet.

- Dokumentacioni teknik për HEC.

Neni 9, pika 4.1.2. Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin.

Nga ana e shoqërisë është deklaruar një kapacitet i transformatorit të fuqisë prej 1.8 MWA i cili është më i ulët se kapaciteti i instaluar i HEC-it.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik.

Neni 9, pika 4.1.4, germa "c" dhe "e".

Shoqëria ka paraqitur në ERE Raportin e Oponencës Teknike të kryer nga AKBN mbi projektin e zbatimit të "HEC Arsti" dërguar në

MIE me shkresën nr. 1943/4 prot, datë 27.4.2017. Oponencë e cila daton pas nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit nr. 1129 rep. dhe nr. 351/1 kol, datë 25.5.2016, "Për ndërtimin e HEC Arsti", të lidhur midis SPV "HEC Arsti" sh.p.k. dhe MIE. Kjo Oponencë që ka depozituar shoqëria në ERE, nuk rezulton të ketë marrë miratimin nga MIE të Projektit të Zbatimit apo të jetë shoqëruar me nënshkrimin e kontratës shtesë të koncesionit, sipas rekomandimit të AKBN-së.

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

- Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" në nenin 10, pika 4, parashikon se: ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4, të nenit 8, të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

- Në pikën 4, të nenit 8, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" parashikohet se: Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE, duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës, për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes se lejeve nga institucionet e tjera.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "HEC Arsti" sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Arsti", për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE BORDI
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 159, datë 29.10.2019

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "DEVOLL HYDROPOWER" SHA, ME NR. 274, SERIA T15, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 35, DATË 4.3.2015, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/5 prot, datë 23.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për licencimin e shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 529 prot, datë 2.9.2019, ka paraqitur kërkesën për rinovim licence në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 143, datë 24.9.2019, ka filluar procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., nr. 274, seria T15, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 35, datë 4.3.2015, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5- vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 35/43, datë 24.9.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Devoll Hydropower" sh.a.

- Me shkresën nr. 588 prot, datë 29.9.2019, u njoftua shoqëria, lidhur me vendimmarrjen e bordit, si dhe me kërkesën për plotësimin e dokumentacionit të munguar në aplikim.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 588/1 prot, datë 11.10.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria "Devoll Hydropwer" sh.a., është mbajtëse e licencës me nr. 274, seria T15 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të bordit të ERE-s, nr. 35, datë 4.3.2015, me afat 5-vjeçar, afati i së cilës përfundon në datë 4.3.2020.

- Rezulton se shoqëria ka aplikuar 4 muaj para përfundimit të afatit për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, e cila është në përputhje me afatin ligjor për paraqitjen e kërkesës për rinovim licence.

- Aplikimi i shoqërisë "Devoll Hydropower" sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikimin (neni 9, pika 1, germat: "a", "b" "c"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c", "d"), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë "Devoll Hydropwer" sh.a., me nr. 274, seria T15 të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 35, datë 4.3.2015, në veprimtarinë e Tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar që nga data 5.3.2020.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE BORDI
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 160, datë 29.10.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË HEC–i "KABASH POROCAN" SHPK, PËR LËNIEN NË HIPOTEKË DHE BARRË TË ASETEVE NË FAVOR TË BANKËS "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA

Në mbështetje të nenit 16; nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8, të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 të "Kushteve të licencës" të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, gjithashtu dhe nenit 19, pika 1, germa "a" dhe pika 3, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/6 prot, datë 23.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë

"HEC-it 'KABASH POROCAN"' sh.p.k., për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të bankës "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a.,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 590 prot, datë 25.9.2019, shoqëria "HEC-i 'KABASH POROCAN"' sh.p.k, ka kërkuar lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve që disponon në favor të bankës "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a. për efekt të marrjes së një kredie në vlerë 4 (katër) milion euro, për financimin e ndërtimit të HEC-eve "Holta Kabash" dhe "Holta Porocan".

- Kjo shoqëri, është krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, pika 1, të Kontratës Koncesionare nr. 4581 rep, nr. 3418 kol, datë 6.10.2008, "Për ndërtimin me koncesion të formës BOT, të HEC-eve 'Holta Kabash' dhe 'Holta Porocan', të lidhur ndërmjet shoqërisë 'Atlas' sh.a. në cilësinë e Koncesionarit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues", në zbatim të VKM-së nr. 882, datë 12.12.2007 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të HEC-eve 'Holta Kabash'" dhe 'Holta Porocan"'.

- Shoqëria "HEC-i "KABASH POROCAN" sh.p.k, është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 297, seria PV15K, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 94, datë 28.7.2015, për një periudhë 30-vjeçare dhe e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, me nr. 298, seria T15, miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 95, datë 28.7.2015.

- Aplikimi plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të licencuarit si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat: "a", "b", "d", "h", janë plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 1, germa "c" (gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve). Plotësuar pjesërisht.

- Neni 7, pika 1, germa "e" (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit). Shoqëria ka deklaruar se arsyeja kërkesës për miratimin e lënies hipoteke/barrë është financimi i ndërtimit të HEC-eve "Holta Kabash" dhe "Holta Porocan".

- Nga të dhënat që disponon ERE, konstatohet se nga raportimi i OSHEE sh.a. rezulton se HEC-et "Holta Kabash" dhe "Holta Porocan" janë në operim, dhe janë të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Për vitin 2019 respektivisht kanë prodhuar energji për të gjithë muajt.

- Neni 7, pika 1, germa "f" (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit). Pa plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa "g" (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar). Pa plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa "i" (Deklaratë me shkrim e personit (subjektit) tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shpreh gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit). Pa plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa "j" (Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt). Pa plotësuar.

- Neni 7, pika 3, (Subjektet koncesionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Organit Shtetëror të Autorizuar (MEI) në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve). Plotësuar pjesërisht.

- Neni 7, pika 4, (Kërkesa, informacioni dhe dokumentacioni i bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë të nënshkruar nga personi ose personat e autorizuar nga shoqëria që kanë kompetencën për përfaqësimin e personit mbajtës licence apo të kandidatit të propozuar). Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "HEC-i KABASH POROCAN" sh.p.k, "Për lënie në hipotekë dhe barrë të aseteve të shoqërisë, në favor të bankës 'Intesa Sanpaolo Bank Albania' sh.a..

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE BORDI
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 161, datë 29.10.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "PËRPARIMI SK" SHPK, PËR LËNIEN NË HIPOTEKË DHE BARRË TË ASETEVE NË FAVOR TË BANKËS "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, germa "a"; nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, pikat 1.3 dhe 1.6 të "Licencës së prodhimit të energjisë elektrike", si dhe neneve 6, 7 dhe 8 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit" miratuar me vendimin e bordit të ERE-s me nr. 119, datë 21.7.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a" dhe pika 3, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "PERPARIMI SK" sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nr. 98/2 prot, datë 23.10.2019 mbi "Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'PËRPARIMI SK' sh.p.k., për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të bankës "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a.

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 592 prot, datë 25.9.2019, shoqëria "PËRPARIMI SK" sh.p.k., ka kërkuar lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve që disponon "PËRPARIMI SK" sh.p.k në favor të bankës Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a. për efekt të marrjes së një kredie në vlerë 1.000.000 euro, për financimin e ndërtimit të HEC-ve "Shtika".

- Shoqëria "PËRPARIMI SK" sh.p.k., është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 329, seria PV16K, miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 15, datë 16.2.2016, për një periudhë 30-vjeçare dhe e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 330, seria T16, miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 16, datë 16.2.2016.

- Në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhëniet kredidhënës-kredimarrës dhe specifikisht, neni 44, i ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, si dhe të pikës 1.3, të licencës për prodhimit të energjisë elektrike, subjekti ka kërkuar miratimin nga ana e ERE-s, të kërkesës për vendosjen në hipotekë dhe barrë të aseteve që disponon.

- Aplikimi i shoqërisë "PERPARIMI SK" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e vendosura në nenin 7, të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve të të licencuarve" , si më poshtë vijon:

Nenin 7, pika 1, germat: "a", "b", "d", "h" janë plotësuar.

- Neni 7, pika 4 dhe pika 6, janë plotësuar

- Subjekti i mësipërm është krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, pika 1, të Kontratës Koncesionare, nr. 2885 rep, nr. 390 kol, datë 11.9.2009, "Për ndërtimin me Koncesion të formës BOT, të HEC-ve: 'Shtika 1', 'Shtika 2', 'Shtika 3' dhe 'Shtika 4' të lidhur ndërmjet shoqërisë 'Qeramika e Jugut' sh.p.k., me cilësinë e Koncesionarit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e Autoritetit Kontraktues, në zbatim të VKM-së nr. 195, datë 19.2.2009 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të HEC-eve 'Shtika'. Kjo shoqëri është regjistruar në datën 17.7.2012, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", me NIPT- in përkatës: K99601201L dhe mban statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

- Objekti i veprimtarisë në përputhje me Kontratën e Koncesionet do të jetë: Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Shtika 1", "Shtika 2", "Shtika 3" dhe "Shtika 4", tek Autoritetet Kontraktuese, ku përfshihen financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transferimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, në zbatim të kësaj kontrate koncesioni.

- Shoqëria "PËRPARIMI SK" sh.p.k., me cilësinë e kredimarrësit, ka lidhur një Kontratë Hipotekimi, me bankën "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a., me cilësinë e kredidhënësit dhe njëkohësisht si përfitues i hipotekës, me qëllimin garantimin e të dy palëve, lidhur me përmbushjen e detyrimeve të ndërsjella të parashikuar në kontratën e kredisë nr. 7775 rep, dhe nr. 2515 kol, datë 13.8.2019.

- Shoqëria "PËRPARIMI SK" sh.p.k. me cilësinë e barrëdhënësit, ka realizuar një Marrëveshje Siguruese, me bankën "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a., me cilësinë e barrëmarrësit, me qëllim që të sigurojë ekzekutimin e plotë të "Detyrimeve të Siguruara", të rrjedhura për "kredimarrësin" nga "Kontrata e Kredisë".

- Në përmbajtje të kontratave referohet prezenca e anekseve të cilat nuk rezultojnë të jenë depozituar.

- Këto kontrata janë përcjellë në ERE në fotokopje të pa njehsuar me origjinalin ç'ka nuk është në pajtim me parashikimet e nenit 8 "Paraqitja e aplikimit", të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike",

- Neni 7, pika 1, germa "c", gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve, është pa plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa "e", është plotësuar pjesërisht. Në plotësim të kësaj kërkese shoqëria ka deklaruar se arsyeja e lënies hipotekë/barrë është financimi i ndërtimit të HEC "Shtikës". Në përmbajtjen e Kontratës së Kredisë Bankare, rezulton se qëllimi i kontratës së huas është: "Shlyerja e detyrimeve të maturuara përkundrejt furnitorëve ....".

- Referuar të dhënave që ERE disponon, rezulton se, HEC "Shtika" është në operim, dhe është i lidhur në nivelin e tensionit 10 kV.

- Neni 7, pika 1, germa "f". Efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit, është pa plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa "g". Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar, është pa plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa "i". Deklaratë me shkrim e personit (subjektit) tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit, plotësuar pjesërisht.

- Neni 7, pika 1, germa "j". Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt, është e pa plotësuar.

- Neni 7, pika 3. Subjektet koncesionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe Miratimin e Organit Shtetëror të Autorizuar (MEI) në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve, është plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "PËRPARIMI SK" sh.p.k., për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të bankës "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a"

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE BORDI
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 162, datë 29.10.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË HEC "LASHKIZA" SHPK PËR LËNIEN NË HIPOTEKË DHE BARRË TË ASETEVE NË FAVOR TË BANKËS "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA

Në mbështetje të nenit 16; nenit 44, pika "1", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8, të "Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit" të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 të "Kushteve të licencës" të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, gjithashtu dhe nenit 19, pika 1, germa "a" dhe pika 3, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/3 prot, datë 23.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë "HEC Lashkiza" sh.p.k., për lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve në favor të bankës "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a.,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 591 prot, datë 25.9.2019, shoqëria "HEC LASHKIZA" sh.p.k., ka kërkuar lënien në hipotekë dhe barrë të aseteve që disponon shoqëria HEC LASHKIZA sh.p.k., në favor të bankës "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a., për efekt të marrjes së një kredie për financimin e ndërtimit të projektit të shoqërisë HEC LASHKIZA sh.p.k.

- Kjo shoqëri, është krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, pika 1, të Kontratës koncesionare, nr. 8300 rep, nr. 2954 kol, datë 27.6.2012, "Për ndërtimin me koncesion të formës BOT, të HEC-eve: "Lashkiza 1", "Lashkiza 2" dhe "Lashkiza 3", të lidhur ndërmjet Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive "Spartaku" sh.p.k., dhe "ERPA INVEST" sh.p.k me cilësinë e koncesionarit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes me cilësinë e Autoritetit Kontraktues, në zbatim të VKM-së nr. 537, datë 27.7.2011 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të HEC-eve 'Lashkiza 1', 'Lashkiza 2' dhe 'Lashkiza 3'.

- Shoqëria "HEC LASHKIZA" sh.p.k., është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 337, seria PV16K, miratuar me vendimin e bordit të Komisionarëve të ERE-s nr. 41, datë 12.4.2016, për një periudhë 30-vjeçare dhe e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, me nr. 338, seria T15, miratuar me vendimin e bordit të Komisionarëve të ERE-s nr. 42, datë 12.4.2016.

Aplikimi plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit" si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat: "a", "b", "d", "h", janë plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 1, germa "c" (gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve). Plotësuar pjesërisht.

- Neni 7, pika 1, germa "e" (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit). Plotësuar pjesërisht.

- Nga të dhënat që disponon ERE-ja nga raportimi i OSHEE sh.a dhe OST sh.a, rezulton se HEC-et: "Lashkiza 1" dhe "Lashkiza 2", janë në operim, dhe janë të lidhur në nivelin e tensionit 110 kV. Për vitin 2019 respektivisht kanë prodhuar energji për të gjithë muajt. Sa më sipër për HEC-in "Lashkiza 3", nuk rezulton që shoqëria të jetë e licencuar, dhe nuk ka të dhëna lidhur me ndërtimin e tij.

- Neni 7, pika 1, germa "f" (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit). Pa plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa "g" (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar). Pa plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa "i" (Deklaratë me shkrim e personit (subjektit) tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit). Pa plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa "j" (Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt). Pa plotësuar.

- Neni 7, pika 3 (Subjektet koncesionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e

transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Organit Shtetëror të Autorizuar (MEI) në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve). Plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "HEC LASHKIZA" sh.p.k., për lënie në hipotekë dhe barrë të aseteve të shoqërisë, në favor të bankës "Intesa Sanpaolo Bank Albania" sh.a..

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE BORDI
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 1101, datë 1.11.2019

PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME, PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. AGIM YMER KAJMAKU, ME FUNKSION KRYETAR I BASHKISË VORË, QARKU TIRANË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015, "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 1.11.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri, kryetar
Denar Biba, zëvendëskryetar
Bledar Skënderi, anëtar
Edlira Jorgaqi, anëtare
Rezarta Bitri, anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion kryetar i Bashkisë Vorë, qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 10, pika 1, germa "d", i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu III, pika 3, germa "ç" i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN

I

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit, për subjekte si më poshtë:

- deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
- kandidatët për deputet dhe në organet e qeverisjes vendore.

Z. Agim Ymer Kajmaku, aktualisht me funksionin kryetar i Bashkisë Vorë, në datën 13.5.2019, referuar ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen,

emërohen ose ushtrojnë funksione publike", së bashku me dokumentacionin e kandidimit ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe formularin e vetëdeklarimit me nr. unik 3253.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Agim Ymer Kajmaku, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë në lidhje me dënim me vendim të formës së prerë nga autoritete gjyqësore shqiptare apo të huaja, dënime me vendime jopërfundimtare nga autoritete gjyqësore shqiptare apo të huaja, masa sigurimi personal, urdhërndalimi ndërkombëtar, ndalime nga organet ligjzbatuese, dëbime apo hetime brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në rubrikën I.B të formularit të vetëdeklarimit, ka deklaruar gjenealitete të mëparshme Jorgo Toto, ndërsa në rubrikën III.8 ka deklaruar se ka jetuar për më shumë se 1 (një) muaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në Athinë, Greqi për arsye emigracioni për periudhën 1991–1996 dhe në Ascoli Picena, Fermo, Itali, për arsye biznesi përgjatë periudhës 1998–1999.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa 'b" dhe pika 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 3669 prot, datë 16.5.2019, dhe nr. 3695 prot, datë 16.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, për verifikimin e të dhënave për funksionarët publikë që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Nga ana e zyrës së gjendjes gjyqësore, me shkresën nr. V-1525/1 prot, datë 17.5.2019, është dërguar verifikimi i gjendjes gjyqësore për të gjithë funksionarët publikë që kemi kërkuar, nga ku rezulton se subjekti vetëdeklarues z. Agim Kajmaku është i padënuar. Përgjigjja nga zyra e gjendjes civile për këtë funksionar publik nuk ka ardhur akoma në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve.

Duke qenë se z. Agim Ymer Kajmaku ka kandiduar për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 30.6.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të dispozitave të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", bëri verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit për këtë funksionar publik. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, përgjigjes së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezultoi se kandidati nuk ishte në kushtet e moszgjidhshmërisë dhe me vendimin nr. 470, datë 17.5.2019, vendosi njoftimin e KZAZ-së për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e kandidatit për kryetar, Bashkia Vorë, qarku Tiranë, të propozuar nga koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

II

Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 2193/2, datë 23.8.2019, i ka kërkuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për z. Agim Ymer Kajmaku.

Pas verifikimit të formularit në përputhje me nenin 15, pika 1, të ligjit 138/2015 dhe kreu VI, pika 6, kreu V, pika 3, germa "b" e vendimit të Kuvendit 17/2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 14197 prot, datë 27.8.2019, ka përcjellë të dhënat e administruara nga KQZ-ja për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, për funksionarin publik z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion kryetar i Bashkisë Vorë, qarku Tiranë.

Me shkresën nr. 2193/68 prot, datë 28.10.2019, Prokurori i Përgjithshëm, Sektori i Verifikimit të Integritetit, pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, në Prokurorinë e Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin e rezultatit të verifikimit në zbatim të ligjit 138/2015, për subjektin z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion kryetar i Bashkisë Vorë.

Sipas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme "Për miratimin e rezultatit të verifikimit në zbatim të ligjit 138/2015, për subjektin z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion kryetar i Bashkisë Vorë" rezulton se:

Më datë 23.8.2019 është depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme kërkesa e Partisë Demokratike, me objekt "Verifikimin e pastërtisë së figurës së shtetasit Agim Kajmaku alias Jorgo Toto". Në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të

nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kërkesa është shoqëruar me nënshkrimet e jo më pak se 500 shtetasve me të drejtë vote.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 2629/1 prot, datë 27.8.2019 ka vënë në dispozicion të Prokurorisë së Përgjithshme dokumentin "Vërtetim i gjendjes gjyqësore nr. 11 prot, datë 27.8.2019, sipas të cilës rezulton se z. Agim Ymer Kajmaku (Jorgo Toto), figuron "i padënuar" brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 6854/1 prot, datë 29.8.2019, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të subjektit Agim Ymer Kajmaku, sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave rezulton se subjekti në datën 6.2.1996, ka ndryshuar përbërësit e gjendjes civile, rubrikën e emrit/mbiemrit nga "Agim Kajmaku" në "Jorgo Toto". Në datën 30.3.2004, rezulton t'i ketë ndryshuar përsëri këto përbërës nga "Jorgo Toto" në "Agim Kajmaku".

Nga verifikimet e kryera nga Prokuroria e Përgjithshme në sistemin TIMS, rezulton se z. Agim Kajmaku, me atësi "Ymer" dhe amësi "Maxhe", me datëlindje 6.7.1971, lindur në Fushë-Prezë, Tiranë, ka të njëjtat gjenealitete, të cilat i ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit. Në sistem nuk rezulton të jetë ndonjë person tjetër me këto të dhëna.

Gjithashtu në sistemin TIMS rezulton i regjistruar dhe shtetasi Jorgo Toto, me atësi "Imer" dhe amësi "Maxhe", i datëlindjes 6.7.1971, pasaportë me nr. 20148497, i cili në sistem ka të njëjtën pamje në fotografi me shtetasin Agim Kajmaku.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 13255/1 prot, datë 27.8.2019, informon se pas verifikimeve të kryera shtetasi Agim Kajmaku (Jorgo Toto) nuk figuron i ndaluar/arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe ky shtetas nuk ka të regjistruara gjenealitete të tjera, përveç Agim Kajmaku dhe Jorgo Toto.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Emigracionin, me shkresat nr. 3269/1 prot, datë 29.8.2019 dhe nr. A-107/4 prot, datë 26.9.2019, ka vënë në dispozicion fotokopje të sistemit TIMS të shtetasit Agim Kajmaku dhe shtetasit Jorgo Toto.

Për një verifikim më të thelluar, bazuar në përcaktimet e nenit 8, të ligjit nr. 138/2015, është realizuar në datën 28.8.2019 marrja e gjurmëve të gishtave të subjektit Agim Kajmaku nga databaza e të dhënave të kompanisë ALEAT sh.p.k., e cila administron të dhënat biometrike të shtetasve shqiptare. Po kështu janë depozituar gjurmët daktiloskopike pranë Institutit të Policisë Shkencore në datën 3.9.2019, dhe nga vetë subjekti Agim Kajmaku.

Me shkresën nr. 931/1 prot, datë 29.8.2019, struktura e Verifikimit të Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike pranë Prokurorisë së Përgjithshme, i ka dërguar Zyrës Qendrore Kombëtare Interpol, gjurmët daktiloskopike të shtetasit Agim Kajmaku për t'i verifikuar me autoritetet homologe të tyre jashtë vendit, duke e njohur me dyshimet e paraqitura në lidhje me arrestimin në flagrancë në territorin e shtetit grek në vitin 2003 dhe se ndaj tij pretendohet se është një filluar një proces penal dhe gjyqësor për "Përdorim dhe shpërndarje të kartëmonedhave të falsifikuara".

Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tiranë, me shkresën nr. 10709/6 prot, datë 24.9.2019, ka sqaruar se nga informacioni i marrë nga zyra homologe Interpol Athinë/Greqi, rezulton se nga krahasimi daktiloskopik i gjurmëve të gishtave të shtetasit Agim Kajmaku, me gjurmët daktiloskopike që ndodhen në databazën e të dhënave kriminale të Greqisë, këto gjurmë përputhen me gjurmët e gishtave të shtetasit Jorgo Toto.

Me shkresën nr. 10709/9 prot, datë 22.10.2019, (protokolluar në Prokurorinë e Përgjithshme në datën 23.10.2019) Zyra Qendrore Kombëtare Interpol saktëson se nga informacioni i marrë nga zyra homologe Interpol Athinë/Greqi rezulton se shtetasi Jorgo Toto, i biri i Imer dhe Maxhe, me datëlindje 6.7.1976, gjurmët e të cilit përputheshin me gjurmët daktiloskopike të shtetasit Agim Ymer Kajmaku, është arrestuar në datën 14.1.2003, për qarkullim monedhash të falsifikuara. Më 13.9.2019, sipas vendimit nr. 236/2019 të Gjykatës së Janinës, ky person është shpallur i pafajshëm. Sa më sipër autoritetet gjyqësore greke kanë revokuar urdhërarrestin kombëtar dhe evropian, për këtë shtetas.

Me shkresën nr. 931/2 prot, datë 30.8.2019 dhe shkresën nr. 931/8 prot, datë 14.10.2019 i është kërkuar Ministrisë së Drejtësisë, të komunikojë më autoritetet e drejtësisë së Republikës së Greqisë për të siguruar informacion dhe dokumentacion në lidhje me arrestime/ndalime; masa sigurimi personale, vendime dënimi penal; vendime dëbimi, në emër të shtetasit Agim Kajmaku alias Jorgo Toto. Kjo kërkesë është përcjellë nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Drejtësisë së Greqisë, në datën 4.9.2019. Aktualisht, nuk ka një përgjigje në lidhje me sa është kërkuar.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresat nr. 12186/1 prot, datë 11.9.2019 dhe nr. 13968/1 prot, datë 30.9.2019, ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme se për periudhën nga data 1.1.2009 e deri në kthimin e përgjigjes, për shtetasin Agim Kajmaku (Jorgo Toto) rezulton:

Kallëzim penal nr. 3381/10, mbi bazën e të cilit në datën 21.9.2010 është regjistruar procedimi penal nr. 3825/10, për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky procedim penal është pushuar me vendimin e datës 15.2.2011.

Kallëzim penal nr. 11718/17, mbi bazën e të cilit në datën 25.9.2017 është regjistruar procedimi penal nr. 7664/17, për veprën penale të "Plagosjes së lehtë me dashje", parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Ky procedim është pushuar me vendimin e datës 20.12.2017.

Bashkëlidhur kjo, prokurori ka vënë në dispozicion fotokopje të njehsuara me origjinalin të vendimeve të pushimit. Nga përmbajtja e dy vendimeve të pushimit rezulton që ndaj këtij subjekt nuk ka pasur arrest në flagrancë apo ndalim nga autoritetet policore dhe ndaj tij nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi gjatë procesit penal.

Nga informacioni i përcjellë nga prokuroritë e tjera pranë gjykatave të shkallës së parë, gjykatave të apelit dhe Prokuroria për Krime të Rënda, Tiranë, rezulton se ndaj subjektit Agim Kajmaku, nuk janë regjistruar procedime penale, nuk ka qenë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi dhe nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

Për sa më sipër rezulton se verifikimi është kryer i plotë, i gjithanshëm dhe konstatohet se subjekti deklarues Agim Ymer Kajmaku, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka qenë në hetim dhe është arrestuar në flagrancë për qarkullim monedhash të falsifikuara. Ndërkohë me vendimin datë 13.9.2019, nr. 236/2019, të Gjykatës së Janinës, është shpallur i pafajshëm. Gjithashtu ka qenë në hetim për dy raste nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë, por në të dy rastet procedimet penale janë pushuar. Për këtë arsye subjekti nuk përfshihet në asnjë nga rastet e ndalimeve të parashikuara në nenin 2, të ligjit nr. 138/2015.

Ndërkohë Prokuroria e Përgjithshme, konstaton se subjekti deklarues, Agim Kajmaku (alias Jorgo Toto) përfshihet në përcaktimet e pikës 3, germa "ç", kreu III-të, i vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, pasi:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi i Kuvendit nr. 17/2016, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar që subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj.).

Vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", është miratuar bazuar në detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 138/2015. Vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, ka miratuar formularin e vetëdeklarimit, sipas formatit të përcaktuar në kreun e III-të të tij. Ndërkohë ne kreun III-të, pika 3, germa "ç", thuhet se "pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të, passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik".

Subjekti Agim Ymer Kajmaku me vullnetin e tij të lirë ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit, ka nënshkruar në çdo faqe të tij, duke konfirmuar të dhënat që vetë ai ka paraqitur dhe njëkohësisht ka konfirmuar dijeninë e tij në lidhje me parashikimet e pjesës së II-të të formularit të vetëdeklarimit (faqe 2) "Marrja dijeni mbi efektet e formularit dhe të

vetëdeklarimit", ku, ndër të tjera thuhet se: germa "d": "Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.".

Nga verifikimet e kryera nga Prokuroria e Përgjithshme është provuar se shtetasi Agim Kajmaku dhe shtetasi Jorgo Toto, është i njëjti person. Ky fakt konfirmohet nga të dhënat e sistemit TIMS, konfirmohet nga fakti që gjurmët daktiloskopike të shtetasit Agim Kajmaku dhe shtetasit Jorgo Toto tregojnë se është i njëjti person, por ky fakt është pranuar dhe nga vete subjekti, i cili ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit që ka përdorur emër/mbiemër Jorgo Toto.

Subjekti Agim Kajmaku, në përgjigje të pyetjes 3, faqe 4, të formularit të vetëdeklarimit: "A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?", ka deklaruar "jo". Pra, rezulton se ai nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit procedimin penal të regjistruar ndaj tij nga autoritet Greke të drejtësisë për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara, si dhe faktin që ka qenë në gjykim nga autoritetet Greke të drejtësisë.

Subjekti Agim Kajmaku, në përgjigje të pyetjes 4, faqe 4, të formularit të vetëdeklarimit: "A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale", ka deklaruar "jo". Pra, rezulton se ai nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit faktin që është arrestuar në flagrancë në datën 14.1.2003 në Greqi, për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara.

Nga verifikimet e kryera konfirmohet se subjekti Agim Kajmaku ka pasur dijeni të plotë në lidhje me faktin që ka qenë në hetim penal në Greqi dhe se ndaj tij kishte një proces gjyqësor penal në zhvillim. Kjo, sepse ai është arrestuar në flagrancë dhe ka dalë para gjykatës Greke ku i është bërë e ditur e gjithë procedura që do ndiqet ndaj tij. Nga ana tjetër rezulton se subjekti ka kryer veprime konkrete për fshehjen e këtij fakti para autoriteteve shqiptare, duke ndryshuar në datë 30.3.2004, emër/mbiemër nga "Jorgo Toto" në "Agim Kajmaku", si dhe duke mos e deklaruar këtë fakt në formularin e vetëdeklarimit.

III

Referuar nenit 33, 42 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ z. Agim Ymer Kajmaku, për të dhënë mendime dhe shpjegime për faktet dhe rrethanat e çështjes.

Përfaqësuesi me prokurë i z. Agim Kajmaku, avokat z. Isuf Shehu, përfaqësuar me prokurë, në pretendimet e tij deklaroi se:

1. Vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Agim Ymer Kajmaku është krejtësisht i gabuar, i paplotë dhe pa fakt, që bie ndesh me frymën e ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar.

2. Detyrat e Prokurorisë së Përgjithshme janë të përcaktuara në kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, dhe nuk ka administruar asnjë provë shkresore në lidhje me një vendim të formës së prerë, që përmban dënimin ose vendosjen e masës së sigurisë apo mbi bazën e të cilës është lëshuar një urdhër kërkimi ndërkombëtar. Vendimi i Kuvendit nr. 17/2016 përcakton se administrimi i akteve bëhet në rrugë zyrtare, ndaj edhe procesi i verifikimit si një proces administrativ nuk mund të përfundojë sepse bie në kundërshtim me pikat 12, 13 e 14, të kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, të cilat kërkojnë që vendimmarrja të merret bazuar në punën e Prokurorisë dhe jo opinionet e saj.

3. Sa i takon çështjes së mospasqyrimit në "formularin e vetëdeklarimit" të fakteve lidhur me ndonjë masë sigurimi ose urdhër kërkimi ndaj personit të tij, parashikimi i germës "ç", të pikës 3, kreu III, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nuk përbën një ndër rastet e ndalimit të parashikuar në nenin 2, të ligjit 138/2015, bazuar edhe në praktikën e ndjekur nga vetë KQZ-ja dhe nuk ka asnjë të dhënë që të përfshihet në kushtet e nenit 2, të ligjit 138/2015.

4. Bazuar në vetë rezultatet e verifikimit të Prokurorisë subjekti nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" mbi bazën e të cilit KQZ-ja duhet të marrë vendim.

5. Të lejohet z. Agim Ymer Kajmaku, të vazhdojë të ushtrojë funksionin e kryetarit të Bashkisë Vorë, qarku Tiranë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të rezultateve të verifikimit nga Prokuroria e Përgjithshme, vlerëson se për sa i përket procedurave të ndjekura, për rezultatet e verifikimit në lidhje me të dhënat në formularin e deklarimit, referuar pikës 1 dhe 2, të nenit 8, të ligjit 138/2015 dhe pikës 5, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është kompetencë e Prokurorisë së Përgjithshme.

Në Kreun III, pika 3, "ç", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit parashikohet se:

"….pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të, passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik".

Gjithashtu, subjektet mbajnë përgjegjësinë e plotë dhe janë të vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota dhe të pasakta, në lidhje me të kaluarën e tyre. Duke nënshkruar në pikën II të formularit: "Marrja dijeni mbi efektet e formularit të vetëdeklarimit", shkronja "d": "Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i menjëhershëm i funksionit publik.".

Nga dokumentacioni i përcjellë, konkludohet se subjekti nuk ka deklaruar informacionet që lidhen me hetimet në ngarkim të tij, pavarësisht detyrimit ligjor që buron nga pyetja 3, e formularit të vetëdeklarimit i cili parashikon: "A keni qenë ndonjëherë në hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?".

Duke mos i pasqyruar faktet e mësipërme në formular, konkludohet se veprimi i tij bie në fushën e zbatimit të pikës 3/ç, të kreut III, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se:

Prokuroria e Përgjithshme, ka kryer verifikimin e të dhënave dhe referuar informacionit të ardhur nga Interpol/Athina/Greqi, ka konstatuar se funksionari z. Agim Ymer Kajmaku (alias Jorgo Toto) është arrestuar në datën 14.1.2003, në Greqi, për qarkullim monedhash të falsifikuara. Deri në datën 13.9.2019, datë kur është marrë vendimi 236/2019 i Gjykatës së Janinës, ku është shpallur i pafajshëm, rezulton se ndaj tij ka pasur urdhërarresti kombëtar (grek) dhe evropian, për këtë shtetas.

Duke qenë se funksionari publik është përgjigjur me "jo" pyetjeve të formularit të vetëdeklarimit: "A keni qenë ndonjëherë në hetim apo ne gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?" dhe "A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale", rezulton se ai nuk ka deklaruar se ndaj tij ka pasur hetim, ndalim, apo gjykim nga autoritetet ligj zbatuese Greke. Gjithashtu funksionari i është përgjigjur me "jo" pyetjeve të formularit të vetëdeklarimit: "A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?" dhe "A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj", rezulton se ai nuk ka deklaruar se ndaj tij ka pasur masë shtrënguese e sigurisë personale apo masë dëbimi.

Personi i cili sipas autoriteteve greke është arrestuar dhe gjykuar për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara ka përdorur të dhëna identiteti Jorgo Toto, të cilat nga analiza e gjurmëve të gishtave përputhen me të dhënat aktuale të z. Agim Ymer Kajmaku.

Neni 2, pika 3, i ligjit 138/2015, parashikon se "Ndalimet e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe ndaj personave që, në kohën e kryerjes apo tentativës së kryerjes të veprës penale, të parashikuar në këtë ligj, mbanin të dhëna identiteti të ndryshme nga ato që mbajnë në momentin kur zbatohet ndalimi ndaj tyre.

Subjekti z. Agim Ymer Kajmaku rezulton se ka përdorur në shtetin grek gjenealitete të tjera, të deklaruara si Jorgo Toto në formularin e vetëdeklarimit, por nuk ka deklaruar arrestimin e tij dhe faktin që në momentin e kandidimit ndaj tij ka qenë në fuqi një urdhërarresti kombëtar në shtetin grek dhe urdhërarresti evropian.

Kreu III, pika 3, germa "ç" parashikon: "Formulari i vetëdeklarimit përmban detyrimisht një rubrikë ku pasqyrohet se ... *Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta të paplota dhe të pasakta në të passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik.".*

Në lidhje me faktin nëse mosdeklarimi i të dhënave të cilat parashikohen në pyetjet e formularit të vetëdeklarimit, përbëjnë shkak për ndalimin e ushtrimit të funksionit Komisioni

Qendror i Zgjedhjeve, është shprehur gjerësisht rast pas rasti dhe në vendimet e mëparshme, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015[1]. Gjithashtu vendimet e KQZ-së për raste të ngjashme janë ankuar në rrugë gjyqësore dhe Gjykata Administrative i ka lënë në fuqi.[2]

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar praktikave të deritanishme ka vlerësuar individualisht për çdo funksionar publikë të trajtuar sipas ligjit 138/2015, të dhënat e padeklaruara, arsyen nëse fshehja e tyre nga deklarimi është e qëllimshme apo jo.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar gjetjeve të Prokurorisë së Përgjithshme në vendimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit 138/2015, për z. Agim Ymer Kajmaku me funksion kryetar i Bashkisë Vorë, konstaton se:

Më datë 13.9.2019, sipas vendimit nr. 236/2019 të Gjykatës së Janinës, subjekti Agim Ymer Kajmaku, alias Jorgo Toto, është shpallur i pafajshëm për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara. Sa më sipër bazuar në këtë vendim pas kësaj date autoritetet gjyqësore Greke kanë revokuar urdhërarrestin kombëtar dhe evropian, për këtë shtetas.

Subjekti z. Agim Kajmaku në datën e fillimit të detyrës (5 gusht 2019) nuk ka deklaruar faktin e procedimit penal të regjistruar ndaj tij nga autoritetet greke të drejtësisë për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara, faktin që ka qenë në gjykim nga autoritetet Greke të drejtësisë, apo që ai ka qenë arrestuar dhe se ndaj tij ka pasur urdhërarresti në fuqi në shtetin Grek, dhe urdhërarresti evropian në fuqi, me gjenealitetet Jorgo Toto.

Në lidhje me fuqinë prapavepruese të ligjit nr. 138/2015, i referohemi jurisprudencës gjyqësore. Kështu, në vendimin 80-2017-422, datë 10.2.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë (vendimi ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar) shprehet (në atë rast, në lidhje me ish-deputetin, z. Dashamir Tahiri) se: "pavarësisht se paditësi në datën 29.12.2016 duhej konsideruar si i rehabilituar, mandati i tij si deputet i fituar përmes bërjes së betimit në fillim të shtatorit 2013, është mandat i fituar në kushtet e ndalimit sipas ligjit nr. 138/2015. Konkretisht, bazuar në nenin 14, paragrafi 3 të tij, llogaritja e periudhës së ndalimit fillon nga data e fillimit të detyrës apo e mandatit në vazhdim dhe shtrihet në periudhën që i paraprin kësaj periudhe.".

Në këto kushte, funksionari publik ka paraqitur rrethana apo të dhëna të rreme në formularët e vetëdeklarimit, depozituar ne Komisionin Qendror të zgjedhjeve në datën 13.5.2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar gjetjeve të Prokurorisë së Përgjithshme vlerëson se mosdeklarimi në formularin e vetëdeklarimit, dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën 13.5.2019, të arrestimit, hetimeve dhe vendosjes ndaj tij të urdhërarrestit dhe fshehja e tyre, ka qenë me qëllim, për të penguar institucionet e ngarkuara nga ligji nr. 138/2015, për të kryer verifikim të plotë dhe të gjithanshëm, duke qenë se në momentin e plotësimit dhe të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit në KQZ, ende nuk kishte përfunduar gjykimi i çështjes penale në ngarkim të këtij subjekti dhe respektivisht nuk dihej sesi do të ishte vendimmarrja e gjykatës përkatëse.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2016", shprehet se: *"... Qëllimi i ligjit nr. 138/2015, është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore ,të institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, si dhe të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to apo largimit nga funksioni publik i atyre personave, për të cilët ekzistojnë shkaqet ligjore për të mos u kandiduar, për t'u zgjedhur apo emëruar, por jo të personave që, për një arsye që nuk lidhet me fshehjen e qëllimshme, kanë referuar të dhëna të ndryshme apo të paplota në raport me të dhënat e gjendura ne regjistrat.*[3] ....)

Sipas interpretimit të Kuvendit vetëm nëse fshehja e të dhënave është e paqëllimshme funksionari nuk është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit, apo largimit nga funksioni publik.

Në kuadër të zbatimit të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, informacion i ardhur nga institucioni i Prokurorisë krijon bindjen se funksionari ka shkelur dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtë, transparencën dhe frymën me të cilën funksionon ligji nr. 138/2015,

[1] Vendimet e KQZ-së për çështjen G. Rahovica dhe A. Rakipi, respektivisht nr. 3 dhe 4 , datë 5.1.201.

[2] Vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nr. 80-2018-4702, datë 24.12.2018 dhe nr. 416(80-2019-432), datë 12.2.2019.

[3] Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë (faqe 2)

"Për verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike", dhe rregullimet e detajuara të parashikuara në vendimin nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vlerëson se funksionari publik, kryetar i Bashkisë Vorë, z. Agim Ymer Kajmaku, referuar germës "ç", pikës 3, kreut III, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, është në kushtet për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Referuar nenit 10, pika 1, germa "d", kur verifikohen kushtet për moszgjedhje apo moskandidim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të funksionarit publik.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 10, pika 1, germa "d", i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe kreut III pika 3, germa "ç", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"',

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Vorë, qarku Tiranë, z. Agim Ymer Kajmaku.

2. Ky vendim t'i njoftohet menjëherë Kryeministrit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 925 (3770), datë 17.7.2019, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Edmond Meço, i datëlindjes 22.3.1963, si dhe caktimin e tij nën kujdestarinë ligjore të palës kërkuese, personit juridik kishtar Shtëpia Rregulltare e Bashkësisë Misionarët e Dashurisë Kontemplative, me seli në njësinë administrative Bushat, Bashkia Vau i Dejës.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 644 lekë